EUROPEAN CENTRE
FOR MINORITY
ISSUES KOSOVO

Planprogrami për të Drejtat e Grave

(Për studentët)

Working Towards a
Stable Multi-Ethnic Kosovo



Mbështetur nga

UNITED NATIONS TRUST FUND TO END VIOLENCE AGAINST WOMEN

Kontribuesit
Autor: Natyra Avdiu
Autorët Kontribues: Lura Pollozhani, Nora Huseionovic, Jana Popadic
Perkthyesit: Artan Çollaku
Korrektor: Drenusha Miftari

ECMI Kosova ecmikosova.org
ECMI Kosova është organizata jo-qeveritare kryesore e angazhuar me çështjet e pakicave në Kosovë, me qëllim për të zhvilluar institucionet përfaqësuese dhe gjithëpërfshirëse në komunitet që e mbështesin një Kosovë të qëndrueshme shumetnike.

ECMI Kosova kontribuon në zhvillimin, forcimin dhe zbatimin e legjislacionit përkatës, mbështet institucionalizimin e komuniteteve që lidhen me organet qeveritare, dhe rrit kapacitetin e aktorëve të shoqërisë civile dhe qeverisë për t'u angazhuar me njëri-tjetrin në një mënyrë konstruktive dhe të qëndrueshme.

Rr. Nëna Terezë Nr. 41, Apt. 29,
10000 Prishtinë, Kosova,
Tel. +381 (0) 38 224 473

Rr. Cika Jovina Nr. 3, 1st Fl,
38220 Mitrovicë Veriore, Kosova,
Tel. +381 (0) 64 00 55 488

Drejta e Autorit
© European Centre for Minority Issues (ECMI) Kosova, Shtator 2014. Të gjitha të drejtat e rezervuara. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në sistem të ruajtjes ose të transmetohet në asnjë formë ose në asnjë mënyrë, elektronik, mekanik, foto-kopjim, regjistrimi ose përndryshe, pa lejen paraprake të ECMI Kosovës.

PËRMBAJTJE

1 HYRJE NË TË DREJTAT E NJERIUT 5

Të drejtat civile dhe politike: 8

Të drejtat sociale, ekonomike dhe kulturore: 9

Të drejtat e solidaritetit: 10

2 TË DREJTAT NJERËZORE TË GRAVE 12

Histori të grave: 13

Rast studimor: e drejta e votës për gratë: kur dhe ku? 15

3 BARAZI GJINORE 22

Hyrje në barazinë gjinore 22

Barazia gjinore në Kosovë: 23

Barazia gjinore në realizim e sipër: gjendja në terren 26

Përse është pabarazia gjinore aq e ngulitur/çfarë na tregon historia? 31

Fitueset femra të Çmimit Nobel për Letërsi: 1901 – 2013 37

Fitueset e Çmimit Nobel për Letërsi: *37*

4 STEREOTIPAT DHE PARAGJYKIMET 43

Përkufizimet 43

Stereotipat gjinorë në Kosovë: 45

5 DHUNA ME BAZË GJINORE 49

Hyrje 49

Përkufizime 50

6 DREJTËSIA 59

Cka nënkupton drejtëisa – qasjen në drejtësi? 59

Hyrje 60

Cilët mekanizma sigurojnë drejtësinë në Kosovë? *60*

Sistemi Gjyqësor i Kosovës 63

Mekanizmat e tjerë jo-gjyqësorë që u ofrojnë mbështetje viktimave të shkeljes së të drejtave të njeriut 64

7 PËRFUNDIME: TË DREJTAT NJERËZORE TË GRAVE 66

ANEKS I: AKTIVITETI 1: PYETËSORI I TEMPERATURËS SË TË DREJTAVE TË NJERIUT 68

ANEKS II: ACTIVITY: QËLLOJANI KUSH E KA ZBULUAR KËTË: *A NDIKOJNË QËNDRIMET E NJËANSHME GJINORE NË GJYKIMIN TONË?* 71

BIBLIOGRAFIA..... 72


1 HYRJE NË TË DREJTAT E NJERIUT



Të drejtat e njeriut përbëjnë një tërësi të drejtash që gëzohen ose garancish që mbrojnë individët dhe/ose grupet nga veprimet ose mosveprimet që mund të pengojnë liritë dhe dinjitetin njerëzor të tyre.[1] Çdo qenie njerëzore gëzon të drejtat e tij/saj njerëzore thjesht nga fakti i të qenit qenie njerëzore, dhe kështu nuk mund të thuhet se të drejtat e njeriut janë të dhëna, të merituara, blihen ose trashëgohen. Në thelb të të drejtave të njeriut qëndron **dinjiteti njerëzor**, i cili qëndron mu në thelb të identitetit të njeriut, është i pacenueshëm dhe duhet të respektohet e të mbrohet. Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut (DUDNj), e vitit 1948, ka mishëruar këtë parim në preambulën e saj: *'njohja e dinjitetit të qenësishëm dhe e të drejtave të barabarta e të patjetërsueshme të të gjithë pjesëtarëve të familjes njerëzore përbën themelin e lirisë, drejtësisë dhe paqes në botë'*.[2] Ngjashëm, në nenin 1 të DUDNj thuhet se *'të gjithë njerëzit lindin të lirë dhe të barabartë në dinjitet dhe të drejta'*.[3] Si i tillë, dinjiteti njerëzorë përbën themelin e çdo të drejte dhe kështu realizohet në çdo e drejtë njerëzore që njihet. Një tjetër mënyrë për t'i kuptuar të drejtat e njeriut është që t'i shohësh ato si parzmore: ato janë rregulla të cilat ju mbrojnë, e në të njëjtën kohë ju tregojnë se si duhet të silleni, dhe janë gjyqtarë pasi që mund të ankoheni duke u thirrur në to.[4]

[1] Amnesty International, 'Becoming a Human Rights Friendly School: A guide for schools around the world' (shq. 'Ta bësh një shkollë miqësore ndaj të drejtave të njeriut: udhëzues për shkollat nëpër botë'), 2012, fq. 3
[2] Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, 10 dhjetor 1948, në dispozicion në http://www.un.org/en/documents/udhr/, qasur më 25/03/2014
[3] Neni 1, poaty
[4] Këshilli i Evropës, 'Compass: Manual for Human Rights Education with Young People' (shq. 'Kompas: Doracak për edukimin e të rinjve për të drejtat e njeriut'), Botim i vitit 2012, fq. 382

Një tjetër mënyrë për t'i vështruar të drejtat e njeriut:



Të drejtat e njeriut bazohen në një numër parimesh të rëndësishme, përfshirë:[5]

- **'Universalitetin dhe patjetërsueshmërinë'** – të drejtat e njeriut janë universale (të njëjtat të drejta që vlejnë kudo në botë pavarësisht dallimeve kulturore ose të tjera) dhe se ato nuk mund të merren në asnjë rrethanë. Më tej, 'është detyrë e Shteteve, pavarësisht nga sistemet e tyre politike, ekonomike dhe kulturore, që të promovojnë dhe mbrojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut'.[6]

- **'Pandashmërinë'** – të gjitha të drejtat e njeriut janë të rëndësishme dhe se nuk mund të ndahen në kategori.

- **'Ndërvarësinë dhe ndërlidhshmërinë'** – të gjitha të drejtat e njeriut janë të varura dhe të ndërlidhen me njëra-tjetrën. Kështu, nëse një e drejtë realizohet ose shkelet, kjo mund të ketë ndikim pozitiv ose negativ në një tjetër të drejtë, respektivisht.

- **'Barazinë dhe mosdiskriminimin'** – të gjitha qeniet njerëzore janë të barabarta bazuar në dinjitetin njerëzor të çdo qenieje njerëzore. Mosdiskriminimi nënkupton se personat nuk

[5] Parimet e të drejtave të njeriut siç janë përkufizuar nga Fondi i Kombeve të Bashkuara për Popullsi, në dispozicion në http://www.unfpa.org/rights/principles.htm, qasur më 25/03/2014
[6] Deklarata e Vjenës dhe Programi i Veprimit, miratuar nga Konferenca Botërore për të Drejtat e Njeriut, në Vjenë, para. 5, 25 qershor 1993, në dispozicion në http://www.ohchr.org/en/professionalinterest/pages/vienna.aspx, qasur më 25/03/2014

duhet të gjykohen në bazë të karakteristikave të tyre, si feja, gjinia, përkatësia politike apo orientimi seksual, ndër të tjera.


- **'Pjesëmarrjen dhe përfshirjen'** – të gjitha qeniet njerëzore kanë të drejtë të kenë qasje në informata dhe të marrin pjesë në lidhje me çështjet që ndikojnë në jetën e tyre. Kjo vlen për të gjithë, edhe pse është e rëndësishme që grupet e margjinalizuara, si pakicat etnike, gratë ose personat me aftësi të kufizuara, të mos përjashtohen.

- **'Llogaridhënien dhe sundimin e së drejtës'** – të drejtat e njeriut gëzohen nga të gjithë (zotëruesit e të drejtave), edhe pse shtetet si bartës të detyrimeve janë të obliguar të monitorojnë që ato janë duke u respektuar. Në rastet kur kjo nuk ndodh, atëherë individi i prekur ka të drejtë të kërkojë dëmshpërblim kundrejt shtetit.

Megjithatë, të drejtat e njeriut gjithashtu mund të duken abstrakte dhe madje ndoshta edhe të parëndësishme për gjendjen me të cilën mund të përballeni në shkollën ose në komunitetin tuaj lokal. Për të zotëruar një kuptim të të drejtave kryesore është e rëndësishme t'i shikoni ato si në vijim:

- *Të drejtat civile dhe politike*, të cilat janë zhvilluar gjatë shekullit të shtatëmbëdhjetë dhe të tetëmbëdhjetë, me fokus në lirinë personale dhe mbrojtjen e individit kundër shkeljeve nga ana e shtetit;
- *Të drejtat sociale, ekonomike dhe kulturore* fokusohen në të drejtat e nevojshme për pjesëmarrje të plotë në jetë, jetesë adekuate dhe të drejta kulturore, ndër të tjera; dhe
- *Të drejtat e solidaritetit* u referohen të drejtave kolektive të një shoqërie ose të drejtës së popujve për vetëvendosje, dhe të drejtës për mjedis të shëndoshë.

Të drejtat civile dhe politike:[7]




- E **drejta në jetë** – askush nuk duhet të privohet arbitrarisht nga jeta;
- **Liria nga tortura, skllavëria dhe puna e detyruar** – shteteve u ndalohet të torturojnë dikë brenda territorit të tyre, si dhe që të përfshihen ose lejojnë skllavërinë apo punën e detyruar;
- E **drejta në liri dhe siguri** të personit – kjo nënkupton se askush nuk duhet t'i nënshtrohet arrestimit apo ndalimit arbitrar;
- **Liria e shprehjes dhe mediat** – e drejta për të pasur opinione, pa ndërhyrje, si dhe liria e kërkimit, marrjes dhe plasimit të informatave;
- **Liria e besimit, ndërgjegjes dhe fesë** – liria për të përvetësuar një fe apo besim sipas zgjedhjes, si dhe e drejta për të manifestuar atë fe ose besim;
- **Liria e asociimit dhe mbledhjes** – çdokush ka të drejtë të vendosë nëse do t'i bashkohet ose jo një sindikate dhe e drejta e të qenit në gjendje për të protestuar në mënyrë paqësore;
- E **drejta në jetë private dhe familjare** – e drejta e secilit për jetë private dhe të familjes duhet të respektohet;
- E **drejta në gjykim të drejtë** – të gjithë janë të barabartë para ligjit dhe cilido i akuzuar për një vepër penale është i pafajshëm derisa të dëshmohet fajësia;
- **E drejta në martesë dhe për të krijuar familje** – njeh të drejtën e atyre të moshës për martesë që të lidhin martesë dhe të krijojnë familje, edhe pse kërkohet pajtimi i plotë dhe i lirë i të dyja palëve;
- **E drejta e votës dhe për t'u zgjedhur** – parasheh të drejtën e votimit universal me votim të fshehtë, si dhe të drejtën për të marrë pjesë përmes të qenit të zgjedhur;
- **E drejta e qasjes në dokumente publike** – njeh të drejtën e qytetarëve për të kërkuar qasje në dokumentet e mbajtura nga qeveria në lidhje me çështje të ndryshme me interes;
- **Ndalimi i diskriminimit** – nënkupton të drejtën në barazi, mbrojtjen e barabartë para ligjit dhe mbrojtjen e të gjitha të drejtave, pa diskriminim mbi asnjë bazë të mbrojtur;
- **Liria e lëvizjes** – liria për të lëvizur lirisht dhe liria për të zgjedhur vendbanimin; dhe

[7] Të drejtat e specifikuara janë të përfshira në traktatet në vijim:
Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike, 16 dhjetor 1966, në dispozicion në http://www.ohchr.org/en/professionalinterest/pages/ccpr.aspx, qasur më 25/03/2014;
Këshilli i Evropës, Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, e amendamentuar nga Protokollet nr. 11 dhe 14, 4 nëntor 1950, në dispozicion në http://www.conventions.coe.int/Treaty/en/Treaties/Html/005.htm, qasur më 25/03/2014

- **Të drejtat e fëmijës** – për t'u regjistruar pas lindjes, posedimi i një emri dhe marrja e shtetësisë.

Të drejtat sociale, ekonomike dhe kulturore:[8]

(Përmbushja e këtyre të drejtave varet nga disponueshmëria e burimeve që ka një vend. Prandaj, këto të drejta pritet të realizohen në mënyrë progresive.)



- **E drejta në punë** – përfshin të drejtën e secilit për të pasur mundësi për të fituar të ardhura për jetesën e tij/saj nga puna, si dhe për paga të drejta, pagë të barabartë për punë të barabartë, veçanërisht në lidhje me gratë, kushte të sigurta dhe të shëndetshme të punës, si dhe për pushime, kohë të lirë, kufizim të orarit të punës dhe festa;
- **E drejta në arsimim** – përfshin arsimimin e detyrueshëm dhe fillor pa pagesë për të gjithë, si dhe arsimim të qëndrueshëm e të qasshëm për të gjithë në të gjitha nivelet;
- **E drejta për një standard të përshtatshëm jetese** – përfshin të drejtën për ushqim, veshje dhe strehim adekuat;
- **E drejta në siguri sociale** – është e njohur për të gjithë dhe përfshin sigurimin social;
- **E drejta e secilit** për të gëzuar **standardin** më të lartë të arritshëm **të shëndetit fizik dhe mendor** – shtetet duhet të ndërmarrin hapa për të reduktuar vdekshmërinë foshnjore, si dhe për të parandaluar, trajtuar dhe kontrolluar epidemitë, endemitë, si dhe sëmundjet profesionale dhe të tjera, ndër të tjera; dhe

[8] Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, 16 dhjetor 1966, në dispozicion në http://www.ohchr.org/EN/ProfessionalInterest/Pages/CESCR.aspx, qasur më 25/03/2014

- **E drejta për të marrë pjesë në jetën kulturore** – për të gëzuar artet dhe për të ndarë së bashku avancimet shkencore.

Të drejtat e solidaritetit:[9]



- **E drejta për të jetuar në paqe**;
- **E drejta për vetëvendosje**;
- **E drejta për një mjedis të pastër**;
- **E drejta për zhvillim**; dhe
- **E drejta për burime natyrore**, ndër të tjera.

Të drejtat e sipërpërmendura të njeriut janë të kodifikuara përmes mjeteve të ndryshme në mënyrë që të jenë ligjërisht të detyrueshme dhe t'u ofrohet qytetarëve mundësia për t'u mbështetur në dispozitat përkatëse, si dhe për zbatimin e tyre sa herë që mendojnë se është shkelur një e drejtë e veçantë. Në nivelin ndërkombëtar, kjo përfshin konventat dhe marrëveshjet, të cilat janë traktate – marrëveshje ndërkombëtare ndërmjet shteteve që rregullohet nga e drejta ndërkombëtare dhe është ligjërisht e detyrueshme. Përveç kësaj, të drejtat e njeriut gjithashtu mund të gjenden në Kushtetutat dhe legjislacionin kombëtar. Në Kosovë, një numër traktatesh janë drejtpërsëdrejti të zbatueshëm, që nënkupton se të drejtat që përmbajnë këto dokumente janë të zbatueshme. Për shembull, të gjitha dispozitat që përmban **Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut** dhe **Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike**, ndër të tjera, janë drejtpërsëdrejti të zbatueshme dhe të detyrueshme.[10] Në të njëjtën kohë, Kushtetuta e Kosovës (Kapitulli II) përcakton shumë nga të drejtat e sipërpërmendura, si dhe të një sërë ligjesh në Kosovë njohin të drejtat e tilla,

[9] Të drejtat e tilla aktualisht janë në zhvillim e sipër, dhe prandaj nuk është përmendur një dokument i tillë për qëllime të këtij plan-programi.
[10] Neni 22 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në dispozicion në http://www.kushtetutakosoves.info/?cid=2,250, qasur më 25/03/2014

përfshirë, ndër të tjera, qasjen në dokumente publike[11], ndalimin e diskriminimit[12] dhe barazinë gjinore[13].

Sa u përket të gjitha këtyre të drejtave, Kosova duhet të sigurojnë si në vijim:



Detyra për të **respektuar** nënkupton se shteti nuk duhet të veprojë në atë mënyrë që të ndërhyjë në gëzimin e të drejtave të njeriut




Detyra për të **mbrojtur** u kërkon shteteve që të sigurojnë që të tjerët të mos pengojnë qasjen në të drejta të njeriut



Detyra për të **përmbushur** nënkupton se shtetet duhet të ndërmarrin veprime pozitive për të lehtësuar gëzimin më të mirë të të drejtave të njeriut

[11] Ligji nr. 03/L-215 për Qasje në Dokumente Publike, në dispozicion në http://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2724, qasur më 25/03/2014
[12] Ligji nr. 2004/3 kundër Diskriminimit, në dispozicion në http://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2458, qasur më 25/03/2014
[13] Ligji nr. 2004/2 për Barazi Gjinore, në dispozicion në http://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2457, qasur më 25/03/2014

2 TË DREJTAT NJERËZORE TË GRAVE



Trajtimi i grave nga ana e shoqërisë, e cila në shumë vende/shoqëri ka qenë e organizuar dhe e dominuar nga burrat, nënkuptonte se gratë nuk gëzonin të drejta të barabarta me burrat në shumë sfera të ndryshme të jetës. Rrethanat e tilla si Luftërat Botërore nënkuptonin se roli i grave shihej përmes një perspektive të ndryshme, dhe atë jo vetëm lindja e fëmijëve dhe të qenit amvise. Gjatë luftërave, gratë në tërë botën kanë kontribuuar në mënyra të ndryshme në përpjekjet gjatë luftërave. Në shumë pjesë të Evropës, si në Britaninë e Madhe, pozita e grave në shoqëri ka ndryshuar në mënyrë drastike, si rezultat i luftërave. Një feministe udhëheqëse në Angli, znj. Millicent Fawcett, kishte thënë se 'lufta kishte revolucionarizuar pozitën industriale të grave – ajo i kishte gjetur ato shërbëtore dhe i kishte lënë pas të lira'.[14] Ngjashëm, në Jugosllavi, fillimi i Luftës së Dytë Botërore ka shënuar fillimin e hyrjes së grave në jetën sociale dhe politike, dhe prandaj shumë gra kishin luftuar për të lënë prapa kulturën e rrënjosur patriarkale.[15] Kjo kishte nënkuptuar se gratë ishin të përfshira në role të ndryshme jashtë shtëpisë, përfshirë në luftë kundër armikut, pasi që mbi 100,000 gra kishin luftuar në kuadër të Ushtrisë Nacionalçlirimtare të Jugosllavisë,[16] si dhe si punëtore në fabrika dhe në marrjen përsipër të përgjegjësive të tjera që më herët i kishin mbajtur burrat.

Megjithatë, në të kaluarën grave u ishte ndaluar që të:

- Zotëronin pronë;
- Kërkonin divorc ose të mund të padisnin dikë;

[14] Bourke J, 'Women on the Home Front in World War One' (shq. 'Gratë në frontin e vendit në Luftën e Parë Botërore), në dispozicion në http://www.bbc.co.uk/history/british/britain_wwone/women_employment_01.shtml, qasur më 05/04/2014

[15] Barlovic B, Matejcic B, 'The role of women from World War II to Post-War Yugoslavia. From anti-fascist fighters to unknown heronies' (shq. 'Roli i grave nga Lufta II Botërore deri në Jugosllavinë e pasluftës. Nga luftëtare antifashiste në heroina të panjohura), në dispozicion në http://www.geschichtswerkstatt-europa.org/media/projekte/The%20role%20of%20women.pdf, qasur më 05/04/2014, fq. 4

[16] Ibid fq. 5

- Kishin qasje në planifikim familjar;
- Mbroheshin nga përdhunimet, sulmet seksuale ose dhuna në familje/abuzimi;
- Kishin të drejtën për të votuar dhe për t'u zgjedhur;
- Arsimoheshin;
- Bëheshin pjesë e të njëjtave profesionet si burrat; dhe
- Në kultura të ndryshme, ishte e papërshtatshme që gratë të dilnin vetëm ose të merrnin vendime që do t'u ndryshonin jetën, siç janë ato se me kë të dilnin, me kë të krijonin lidhje ose të martoheshin, dhe që të vendosnin nëse donin të martoheshin dhe lindin fëmijë fare.

Histori të grave:

Caroline Norton 1808 – 1877, Angli[17]

Caroline ishte martuar në moshë të re (16-vjeçare) me një politikan me ndikim, pasi që kishte menduar se nuk mund të refuzonte për shkak të gjendjes në të cilën gjendej familja e saj. Martesa e saj nuk ishte e lumtur, pasi që burri i saj e rrihte pamëshirshëm. Një ditë ajo vendosi se nuk mund të duronte më dhe kështu vendosi të largohej. Megjithatë, ligji nuk ia lejonte të kërkonte divorc ose të kishe qasje te fëmijët e saj. Në anën tjetër, burri i saj kishte të drejtë të linte gruan e tij dhe madje edhe t'ia merrte fëmijët. Pavarësisht se i kishte ikur abuzimit fizik, ajo vazhdonte të përballej me padrejtësi pasi që nuk mund të divorcohej, e as nuk do të mund t'i shihte fëmijët e saj. Duke qenë një grua e vendosur, ajo vendosi të shkruante publikisht mbi përvojën e hidhur e saj dhe padrejtësitë me të cilat vazhdonte të përballej, përfshirë duke iu drejtuar Mbretëreshës së Mbretërisë së Bashkuar për të drejtat që u mohoheshin të gjitha grave në Angli. Pjesërisht për shkak të përpjekjeve të saj, Parlamenti britanik kishte vënë në fuqi legjislacionin e ri më 1839, i cili u lejtonte grave në pozitë si të Carolines që të vizitonin fëmijët e tyre, si dhe në lidhje me divorcin, më 1857.

Ksenija Anastasijević, 1894 – 1981, Beograd, Serbi

Ksenija ishte gruaja e parë që kishte fituar Doktoraturë në filozofi, nga Universiteti i Beogradit, dhe në vitin 1924 ishte bërë Profesoresha e parë femër në Fakultetin e Filozofisë të Universitetit të Beogradit. Ajo ishte anëtare e Lidhjes Serbe të Grave për Paqe dhe Liri, Aleancës së Lëvizjes së Grave, dhe redaktore e revistës së parë feministe, të titulluar 'Lëvizja e Grave' (*Ženski pokret*), të botuar më 1920 – 1938. Si mendimtare liberale dhe e pavarur, ajo kishte refuzuar të bëhej pjesë e qarkut të dominuar nga meshkujt që ekzistonte atëherë. Megjithatë, në vitin 1936 ishte larguar nga posti i saj i Profesoreshës, bazuar në akuza të sajuara për plagjiaturë. Në atë kohë në Beograd ka pasur shprehje publike të pakënaqësive kundër këtij vendimi, me ç'rast shkrimtarë të shquar dhe profesorë të tjerë,

[17] BBC History, në dispozicion në http://www.bbc.co.uk/history/historic_figures/norton_caroline.shtml, qasur më 05/04/2014

si Živojin M. Perić (profesor i së drejtës) dhe Živojin M. Perić (poetit), kishin dalë në mbështetje të saj.

Marina Abramović, 1946 – aktualisht, artiste e lindur në Serbi që vepron në Nju Jork.

Marina, së cilës shpesh i referohen si "gjyshja e artit të performancës", mban dy doktorata nderi për arte. Ajo i ka kushtuar jetën e saj artit, kurrë nuk është martuar dhe ka refuzuar shtetësinë e saj nga lindja, dhe e konsideron veten kozmopolite. Marina mban ekspozitën më të madhe të artit të performancës në Muzeun e famshëm të Artit Modern (MoMA), në Nju Jork. Ajo aktualisht është duke punuar në krijimin e institutit të saj (MAI) në Nju Jork.

Musine Kokalari, 1917 – 1983, Shqipëri

Musinja ishte prozatore dhe politikane në Shqipërinë para komunizmit, dhe njëra nga themelueset e Partisë Demokratike Socialiste të Shqipërisë më 1943. Pas diplomimit në letërsi në Universitetin e Romës La Sapienza, në Itali, në moshën 24 vjeçare, ajo kishte botuar një përmbledhje me prozë, të titulluar 'Seç më thotë nëna plakë'. Ajo kishte vazhduar të shkruante dhe të botonte, megjithëse në vitin 1946 ishte arrestuar dhe dënuar me 20 vjet burg me akuzën se kishte qenë 'armike e popullit' dhe shkrimet e saj ishin ndaluar. Në gjykimin e saj kishte thënë: "Nuk kam nevojë të jem komuniste për të dashur vendin tim. E dua vendin tim edhe pse nuk jam komuniste. E dua përparimin e tij. Ju mburremi se keni fituar luftën, dhe tani që jeni fituesi doni të shuani ata që i quani kundërshtarë politikë. Unë mendoj ndryshe nga ju, por e dua vendin tim. Ju po më ndëshkoni për idealet e mia!' Ajo kishte kaluar 18 vjet në burg dhe më pas ishte transferuar në një kamp, ku kishte kaluar pjesën tjetër të jetës së saj derisa kishte vdekur nga kanceri më 1983 Asaj nuk i ishte lejuar të vazhdonte të shkruante në pjesën e mbetur të jetës, dhe vetëm pas vdekjes ishte shpallur "Dëshmore e Demokracisë' nga Presidenti i Shqipërisë.[18]

Flora Brovina, 1949 – aktualisht, Kosovë

Flora është poete, pediatre dhe aktiviste e të drejtave të grave. Pas diplomimit, ajo kishte punuar si gazetare për gazetën 'Rilindja' dhe më pas kishte filluar të punonte si pediatre. Gjatë shtypjes që kishte ndodhur në Kosovë Flora ka kontribuar në përpjekjet humanitare duke punuar në një klinikë dhe duke u ofruar ndihmë fëmijëve dhe nënave, përfshirë duke u ofruar strehim fëmijëve jetimë. Ajo gjithashtu kishte themeluar Lidhjen e Grave Shqiptare dhe kishte udhëhequr demonstrata paqësore në Kosovë në të cilat ishte kërkuar respektimi i të drejtave të grave, si dhe i të drejtave themelore të njeriut. Në vitin 1999, Flora ishte rrëmbyer nga 8 paramilitarë serbë të maskuar në Prishtinë dhe ishte dërguar në një vend të panjohur. Ajo ishte transferuar në një burg në Pozharevc, ku i ishte nënshtruar sesioneve të gjata të marrjes në pyetje dhe ishte akuzuar për 'veprimtari terroriste'. Për shkak të presionit ndërkombëtar ishte liruar dhe aktualisht është deputete në Kuvendin e Kosovës.

Atifete Jahjaga, 1975 – aktualisht, Kosovë

[18] Pen International, 1960: Musine Kokalari, në dispozicion në http://www.pen-international.org/campaign/past-campaigns/because-writers-speak-their-mind/because-writers-speak-their-minds-50-years-50-cases/1960-musine-kokalari/, qasur më 05/04/2014

Atifetja filloi karrierën e saj në Shërbimin Policor të Kosovës, dhe ishte graduar në pozitën e Zëvendësdrejtoreshës së Policisë së Kosovës. Në vitin 2011 u shpall kandidate konsensuale për Presidente të Kosovës dhe u votua nga shumica e deputetëve të Kuvendit të Kosovës. Presidentja Jahjaga është Presidentja e parë femër e Kosovës dhe Presidentja e parë femër në Ballkan që nga shpërbërja e Jugosllavisë. Gjatë mandatit të saj, ajo është fokusuar në avancimin e të drejtave të grave duke organizuar një samit ndërkombëtar, 'Partneriteti për Ndryshim – Fuqizimi i Grave', i cili është ndjekur nga 200 udhëheqëse nga tërë bota. Përveç kësaj, Presidentja Jahjaga ka themeluar Këshillin Kombëtar për të Mbijetuarat e Dhunës Seksuale të Luftës.

Rast studimor: e drejta e votës për gratë: kur dhe ku?

Në **demokraci** zhvillohen zgjedhje në intervale të ndryshme kohore për nivele të ndryshme të qeverisë, si për qeverinë lokale dhe për kryetar të komunës, si dhe për qeverinë qendrore dhe për deputetë, të cilët janë anëtarë të Kuvendit. Në Kosovë zhvillohen zgjedhje çdo katër vjet dhe secili mbi moshën 18-vjeçare (moshën madhore) kanë të drejtë të votojnë.

Megjithatë, e drejta e votës nuk ka qenë e njohur për të gjithë, pasi që një numër i sistemeve nuk kanë qenë demokratike. Shumë vende në Evropë, për shembull, kanë qenë **monarki absolute**, që do të thotë se një Mbretëresha ose Mbret kanë sunduar popullin dhe vetëm një grup i kufizuar njerëzish (ata që ishin të pasur) gëzonin disa privilegje. Në ndërkohë, vendet që më vonë kishin përvetësuar **komunizmin** kishin një formë të ndryshme të organizimit, i cili mbështetej në kontrollin e tërë aktivitetit ekonomik dhe shoqëror nga një sistem totalitar i dominuar nga një parti politike. Prandaj, në të dyja sistemet ose nuk ka pasur votime ose nëse ka pasur, ai ka qenë për një numër të vogël të privilegjuarish, ndërsa në asnjërin nuk ka pasur zgjedhje të lira. Megjithatë, edhe me demokratizimin e vendeve gratë nuk ishin njohur menjëherë si individë me të njëjtat të drejta të njeriut si burrat, dhe shumë vende kishin dështuar të njihnin **të drejtën universale të votimit** për dekada të tëra, siç mund të shihet në tabelën më poshtë. (**E drejta universale e votimit** nënkupton të drejtën e votës për të gjithë të rriturit zakonisht mbi moshën 18-vjeçare, të përcaktuar me ligj, ndonëse pa dallim në bazë të gjinisë apo përkatësisë etnike).

Viti	Vendi[19]
1893	Zelanda e Re
1902[20]	Australia
1906	Finlanda
1913	Norvegjia

[19] The Guardian, 'A timeline of the women's right to vote – interactive' ('Kronologji kohore e të drejtës së grave për të votuar – interaktive'), 6 korrik 2011, në dispozicion në http://www.theguardian.com/global-development/interactive/2011/jul/06/un-women-vote-timeline-interactive, qasur më 25/03/2014,

[20] Ka pasur kufizime për komunitetet autoktone, të cila janë çrrënjosur me 1962

1915	Danimarka, Islanda
1917	Kanadaja
1918	Azerbajxhani, Estonia, Hungaria, Kirgistani, Letonia, Polonia, Federata Ruse, Austria, Gjermania, Gjeorgjia, Irlanda, Mbretëria e Bashkuar
1919	Bjellorusia, Lituania, Ukraina, Luksemburgu, Holanda, Suedia, Belgjika, Zimbabveja, Kenia
1920	Shqipëria, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Republika Çeke, Sllovakia
1921	Armenia
1924	Taxhikistani, Mongolia, Kazakistani
1927	Turkmenistani
1929	Rumania, Ekuadori
1930	Turqia, Afrika Jugore
1931	Spanja, Shri Lanka, Portugalia, Kili[21]
1932	Brazili, Tailanda, Uruguai, Maldivet
1934	Kuba
1935	Mianmari
1937	Filipinet
1938	Uzbekistani, Bolivia[22]
1939	Salvadori
1941	Panamaja
1943	Republika Dominikane
1944	Franca, Xhamajka, Bullgaria
1945	Kroacia, Sllovenia, Italia, Indonezia, Senegali, Togo, Japonia
1946	Serbia, Mali i Zi, Republika Popullore Demokratike e Koresë, Guatemala, Maqedonia, Vietnami, Trinidadi dhe Tobago, Venezuela, Kameruni, Xhibuti
1947	Malta, Singapori, Argjentina, Meksika, Pakistani
1948	Izraeli, Republika e Koresë, Surinami, Nigeri, Sejshellet, Samoa,
1949	Bosnja dhe Hercegovina, Kina, Kostarika, Greqia, Siria, Hong-Kongu
1950	Barbadosi, Haiti, India,
1951	Shën Lucia, Antiga dhe Barbuda, Dominika, Grenada, Shën Kitts dhe Nevis, Shën Vinsenti dhe Grenadinet, Nepali
1952	Libani, Bregu i Fildishtë
1953	Guajana, Butani

[21] 1949
[22] 1952

1954	Belize, Kolumbia, Gana
1955	Kamboxhia, Hondurasi, Nikaragua, Peruja, Eritrea, Etiopia,
1956	Egjipti, Benini, Komoret, Gaboni, Mali, Mauriciusi, Somalia
1957	Malajzia
1958	Laosi, Burkina Faso, Çadi, Ginea, Nigeria,
1959	San Marino, Tunizia, Madagaskari, Republika e Bashkuar e Tanzanisë
1960	Çipro, Gambia, Tonga
1961	Paraguaji, Burundi, Malavi, Mauritania, Ruanda, Sierra Leone, Bahamet[23]
1962	Algjeria, Monako, Uganda, Zambia
1963	Afganistani, Kongo, Fixhi, Maroko, Irani, Guine Ekuatoriale
1964	Papua Guinea e Re, Libia, Sudani
1965	Botsvana, Lesoto
1967	Republika Demokratike e Kongos, Kiribati, Tuvaluja, Jemeni[24]
1968	Nauru, Svazilandi
1970	Andorra
1971	Zvicra
1972	Bangladeshi
1973	Bahrejni
1974	Ishujt Solomon, Jordania
1975	Angola, Cape Verde, Mozambiku, Sao Tome dhe Principe, Vanuatu
1976	Timori Lindor
1977	Guineja-Bisau
1978	Republika e Moldavisë
1979	Ishujt Marshall, Mikronezia, Palau
1980	Iraku
1984	Lihtenshtajni
1986	Republika e Afrikës Qendrore
1989	Namibia
1994	Omani
2003	Katari
2005	Kuvajti
2006	Emiratet e Bashkuara Arabe[25]

[23] 1964
[24] 1970
[25] Nuk është universale, pasi që ka kufizime si për burra ashtu edhe për gra.

Aktualisht gratë vazhdojnë të përballen me disa nga këto probleme, përfshirë si në vijim:

- Për shkak të normave kulturore, disa gra nuk e trashëgojnë pasurinë të cilën kanë të drejtë ta trashëgojnë (nuk pyeten ose heqin dorë nga kjo e drejtë), janë të detyruara të jetojnë në lidhje të dhunshme dhe nuk mendojnë se është e pranueshme që të kërkojnë divorc, e disa detyrohen të martohen shumë herët, përfshirë në moshë të fëmijërisë;
- Gratë vazhdojnë të përballen me seksizëm dhe diskriminim në vendin e punës, në forma si të mos qenit të paguara njëjtë si burrat për të njëjtën punë, mohimi i ngritjes në detyrë ose largimi nga puna gjatë shtatzënisë me qëllim të shmangies së pagesës së pushimit të lindjes;
- Nëse gratë ankohen për shkeljen e të drejtave të tyre, atyre jo çdoherë u besohet ose nuk merren seriozisht nga ana e autoriteteve përkatëse, për shembull nëse keqtrajtohen nga bashkëshortët e tyre, ose në raste të përdhunimeve; dhe
- Disa shoqëri akoma nuk besojnë se gratë duhet të kenë të njëjtat të drejta si burrat dhe të drejtat e tyre janë të kufizuara në mënyrë drastike, përfshirë në forma si: moslejimi për të dalë vetëm, mohimi i së drejtës për arsimim, detyrimi për t'u martuar ose për të pasur fëmijë, moslejimi për të punuar dhe/ose për të ngarë automjet, ndër të tjera.
  Këshillë: inkurajoni nxënësit tuaj që të përmendin çfarëdo problemesh të tjera me të cilat përballen gratë në ditët e sotme.

Pavarësisht se janë duke u arritur përparime mesatare pas përpjekjeve të grave aktiviste dhe feministe, disa prej problemeve të sipërpërmendura vazhdojnë të mbeten të ngulitura në shumë shoqëri në mbarë botën. Në sferën ndërkombëtare, universaliteti dhe pandashmëria e shumë prej instrumenteve të të drejtave të njeriut nuk duket të ketë ndikimin e dëshiruar në terren, gjë që do të thotë se ata nuk kanë ofruar mbrojtje të barabartë si për burrat ashtu edhe për gratë. Si përgjigje ndaj kësaj gjendjeje dhe duke njohur pozitën e pafavorshme në të cilën vazhdojnë të gjenden gratë, të drejta specifike janë listuar në mënyrë shprehimore me qëllim të udhëzimit të qeverive që të marrin masa të veçanta për të bërë të drejtat e grave realitet.

Një nga dokumentet e para të miratuara që njeh pozitën inferiore në të cilën gjenden gratë në shumë shoqëri është *Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj* Grave (CEDAW).[26] Ajo në mënyrë specifike pranon se **gratë nuk janë inferiore ndaj burrave** dhe kërkon nga autoritetet kombëtare që të eliminojnë paragjykimet dhe zakonin e bazuar në superioritetin e një gjinie dhe rolet e bazuara në stereotipe të burrave dhe grave. Për shembull, nëse në një shoqëri ekziston një besim/zakon sipas të cilit prioritet duhet t'i jepet arsimimit të djemve e jo të vajzave, atëherë autoritetet kombëtare duhet të punojnë për të eliminuar një paragjykim të tillë. Ngjashëm, nëse një komunitet konsideron se vajzat/gratë e martuara duhet të heqin dorë nga e drejta e tyre në trashëgimi ose se ato nuk duhet të përfshihen si pronare të përbashkëta të pronës me burrat e tyre, autoritetet duhet të ngritin vetëdijesimin e tyre rreth pabarazisë dhe padrejtësive që u shkakton kjo grave. Një shembull tjetër do të ishte nëse një komunitet beson se vajzat duhet të martohen në moshë të re (përfshirë në moshë të fëmijërisë), pa konsultim të duhur, me dikë që është më i vjetër, në mënyrë që të sigurohet që ato të kenë dikë që do t'i mbajë të mos mbeten në shtëpi. Sikur në

[26] Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, Konventa për Eliminimin e të Gjihta Formave të Diskriminimit kundër Grave, miratuar më 3 dhjetor 1978, në dispozicion në http://www.un.org/womenwatch/daw/cedaw/text/econvention.htm, qasur më 05/04/2014

shembujt e përmendur më siëpr, një skenar i tillë nxjerr në sipërfaqe pikëpamje stereotipike, të cilat, nëse veprohet në përputhje me to,, shkelin të drejtën e një vajzë/gruaje për dinjitet njerëzor dhe jetë private, dhe prandaj autoritetet kanë për detyrë të informojnë prindërit dhe fëmijët në komunitetet lokale në lidhje me pabarazitë që shkaktojnë praktika të tilla, si dhe të ofrojnë ndihmë kur është e nevojshme. Përveç kësaj, CEDAW njeh të drejtën e grave për të qenë të lira nga diskriminimi pasi që kërkon që burrat dhe gratë të kenë qasje dhe mundësi të barabarta në jetën politike dhe publike, në arsim, shëndetësi dhe punësim, si dhe afirmon të drejtat reproduktive të grave.

Një tjetër dokument i rëndësishëm është *Deklarata e Kombeve të Bashkuara për Eliminimin e Dhunës ndaj Grave*, e cila, është me rëndësi, se njeh se:

- Dhuna ndaj grave është manifestim i marrëdhënieve historikisht të pabarabarta të fuqisë mes burrave dhe grave,
- Dominimi dhe diskriminimi ndaj grave nga ana e burrave ka çuar në parandalimin e përparimit të plotë të grave, dhe
- Dhuna ndaj grave është një nga mekanizmat kryesorë socialë përmes të cilit gratë vihen në pozitë të varësisë në raport me burrat.[27]

Kjo deklaratë rithekson të drejtat e rëndësishme njerëzore me qëllim të sigurimit të mirëqenies së grave, siç është e drejta për liri dhe siguri personale, e drejta për të mos iu nënshtruar torturës ose formave të tjera të trajtimit ose dënimit mizor, çnjerëzor ose degraduese, e drejta e jetës, si dhe e drejta për të qenë të lira nga diskriminimi. Përveç kësaj, ajo u bën thirrje autoriteteve kombëtare që të ndërmarrin masa pozitive për të eliminuar dhunën kundër grave, si dhe përcakton se autoritetet kanë për detyrë të dënojnë dhunën e tillë dhe që të mos thirren në zakone, tradita apo konsiderata fetare për të shmangur detyrimet e tyre. Siç ka deklaruar Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara, Ban Ki Moon, *"Dhuna do të përfundojë vetëm kur përballemi me paragjykimet. Stigma dhe diskriminimi do të përfundojnë vetëm kur të pajtohemi që të ngremë zërin. Kjo kërkon që të gjithë të bëjmë pjesën e punës sonë; që të ngremë zërin në shtëpi, në punë, në shkollat dhe komunitetet tona"* (2010).

Më 1994, gjatë Konferencës Ndërkombëtare për Popullsinë për Zhvillimin (KNPZh), të mbajtur në Kajro, Egjipt, ishte arritur në një tjetër moment historik dhe të drejtave të grave u ishte kushtuar vëmendje edhe në këtë rast, me ç'rast një numër i vendeve ishin zotuar se barazia dhe fuqizimi i grave është prioritet global. Më konkretisht, një numër vendesh kishin rënë dakord që të sigurojnë një qasje universale rreth planifikimit familjar, shërbimeve të shëndetit seksual dhe riprodhues dhe respektimit të të drejtave reproduktive, si dhe që të arrijnë barazinë gjinore, fuqizimin e grave dhe qasje të barabartë të vajzave në arsim.[28] Në vitin 1995, Konferenca e Katërt Botërore për Gratë, në Pekin, kishte gjeneruar zotime të tjera globale për të avancuar të drejtat e grave dhe të vajzave në një sërë fushash, përfshirë arsimin dhe trajnimet, kujdesin shëndetësor, dhunën ndaj grave, gratë

[27] Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, Deklarata për Eliminimin e Dhunës ndaj Grave ence, miratuar më 20 dhjetor 1993, në dispozicion në http://www.un.org/documents/ga/res/48/a48r104.htm, qasur më 05/04/2014

[28] Konferenca Ndërkombëtare për Popullsinë për Zhvillimin, e mbajtur më 5 – 13 nëntor 1994 në Kajro, Egjipt, në dispozicion në http://www.unfpa.org/public/home/sitemap/icpd/International-Conference-on-Population-and-Development/ICPD-Summary, qasur më 05/04/2014

dhe mediat, mjedisin, gratë dhe ekonominë, dhe pushtetin dhe vendimmarrjen, ndër të tjera.[29] Ç'është më e rëndësishmja, në Deklaratën e Pekinit thuhet se *"avancimi i grave dhe arritja e barazisë mes grave dhe burrave janë çështje të të drejtave të njeriut dhe kusht për drejtësi sociale, dhe nuk duhet të shihen të izoluara si një çështje e grave."*

Të drejtat reproduktive përfshijnë: qasjen në kujdesin shëndetësor seksual dhe reproduktiv dhe në informatat përkatëse, si dhe autonomi në vendimmarrje në lidhje me çështjet seksuale dhe reproduktive. Përveç kësaj, gjatë KNPZh-së në Kajro ishte theksuar se kjo përfshin:


- Shërbimet vullnetare, të informuara dhe të përballueshme të planifikimit familjar;
- Kujdesin pas lindjes, shërbime të sigurta të amësisë, ndihmën gjatë lindjes (nga profesionistë të mjekësisë) dhe kujdesin shëndetësor gjithëpërfshirës për të miturit;
- Parandalimin dhe trajtimin e infeksioneve seksualisht të transmetueshme, përfshirë HIV-in dhe SIDA-n dhe kancerin e qafës së mitrës;
- Parandalimin dhe trajtimin e dhunës ndaj vajzave, përfshirë gjymtimin gjenital dhe praktika të tjera tradicionale që do të përbënin torturës;
- Qasjen në abortim dhe kujdesin pas abortimit;
- Qasjen në informata mbi shëndetin seksual, përfshirë edukimin dhe këshillimin; dhe
- Qasjen në kontracepsion.

[29] Avokatët e Minnesotas për të Drejtat e Njeriut, 'Summary of the Beijing Declaration and Platform for Action' (shq. 'Përmbledhje e Deklaratës së Pekinit dhe Platformës për Veprim'), janar 1996, në dispozicion në http://www.theadvocatesforhumanrights.org/uploads/declaration.pdf, qasur më 05/04/2014


Fakte dhe shifra të rëndësishme në mbarë botën

- Çdo vit më shumë se gjysmë milion gra vdesin për shkak të shtatzënisë ose gjatë lindjes së fëmijëve;
- Ka një rritje të numrit të grave të infektuar me HIV në mbarë botën. Në rrezik janë sidomos gratë e moshës 15-24-vjeçare, për shkak të cenueshmërisë së tyre ekonomike dhe sociale;
- Dhuna me bazë gjinore vret dhe u shkakton aftësi të kufizuara aq shumë grave sa kanceri (në moshën 15-44-vjeçare) dhe zakonisht kryerësit nuk ndëshkohen;
- Ka më shumë gra analfabete sesa burra, dhe ato ka më shumë të ngjarë të varfërohen, dhe në shumë vende gratë e punësuara fitojnë më pak se burrat, pavarësisht të qenit të punësuara në të njëjtat pozita;
- Praktikat diskriminuese vazhdojnë të prekin gratë, sidomos lidhur me martesën, tokën, pasurinë dhe trashëgiminë, përkundër ekzistimit të konventave ndërkombëtare;[1]
- Ndërsa 125 vendet e kanë shpallur të paligjshme dhunën në familje, 127 vende nuk e dënojnë shprehimisht përdhunimin brenda martesës, gjë që nënkupton se 603 milionë gra jetojnë në vende ku dhuna në familje nuk përbën krim dhe mbi 602 milionë gra jetojnë në vende ku përdhunimi brenda martesës nuk përbën vepër penale;
- 61 vende kufizojnë ashpër të drejtat e grave për abort;
- 50 vende kanë në fuqi moshë më të ulët të martesës për gratë sesa për burrat; dhe
- Vetëm 28 vende në botë kanë arritur 30% të përfaqësimit të grave në parlamentet kombëtare, 23 nga të cilat vende përdorin kuotat.[1]

3 BARAZI GJINORE







Hyrje në barazinë gjinore

Përkufizime:

Seksi: karakteristikat biologjike dhe fiziologjike që përcaktojnë meshkujt dhe femrat.

Gjinia: rolet, sjelljet, aktivitetet dhe atributet e konstruktuara nga shoqëria të cilat ajo i konsideron të përshtatshme për meshkujt dhe femrat. Për këtë arsye, gjinia nuk është biologjike, por përbën një pritje nga shoqëria në aspektin e cilësive apo sjelljeve të cilave meshkujt dhe femrat u përmbahen. Megjithatë, këto ndryshojnë me kalimin e kohës, dhe kështu meshkujt dhe femrat përshtaten.

Dallimi në mes të dyjave mund të kuptohet edhe në këtë mënyrë: meshkuj dhe femra si seks, dhe mashkullore dhe femërore si gjini. Megjithatë, këto kuptime janë të kufizuara, pasi që ka shumë njerëz të cilët nuk bien në këto dy kategori.

Një shembull i ndryshimit të sjelljeve dhe përshtatjes është e drejtë e grave për të votuar; pra, gratë në të kaluarën nuk kanë mundur të votojnë, pasi që ligji në shumë vende nuk ua ka lejuar këtë. Kjo nuk do të thotë se ato nuk kanë qenë të afta për të votuar, por tregon atë që shoqëria ua ka imponuar. Edhe me vënien në fuqi të të drejtave të barabarta të votimit në shumë vende, pesha e votës së burrave dhe grave nuk perceptohet si e barabartë, edhe është e rëndësishme, pasi që gratë përbëjnë 50% të popullsisë. Megjithatë, gratë vazhdojnë të gjenden në pozitë të pafavorshme në raport me burrat dhe pavarësisht se me ligj trajtohen në mënyrë të barabartë, ato mund të mos

kenë mundësi të të zbatojnë ligjin dhe të ndryshojnë atë që shoqëria ka pritur më parë prej tyre, d.m.th. që të mos përfshihen në çështje të rëndësishme siç është politika.

Barazia gjinore: përfaqësimi matshëm i barabartë i meshkujve dhe femrave, që do të thotë se të dyja gjinitë janë të fuqizuara në mënyrë të barabartë dhe marrin pjesë në të gjitha sferat e jetës publike dhe private. Kjo nuk do të thotë se meshkujt dhe femrat janë të njëjtë, por të pranuarit se janë me vlerë të barabartë dhe kanë të drejtë, si qenie njerëzore, për trajtim të barabartë.

Masat afirmative/diskriminimi pozitiv: masa të përkohshme ose veprime pozitive që ndërmerren duke njohur disavantazhet me të cilat më parë është përballur një grup i veçantë dhe me qëllim të përmirësimit të gjendjes së atij grupi. Masa të tilla përdoren në lidhje me grupet që posedojnë karakteristika të mbrojtura, si përkatësia etnike, feja, gjinia, orientimi seksual, prejardhja shoqërore apo trashëgimia, ndër të tjera.

Është mu gjinia ajo përmes së cilës janë formuar rolet ose pritjet e caktuara ndaj meshkujve dhe femrave, ndonëse në shumicën e shoqërive ndikimi i kësaj shkon në dëm të femrave.

"Gratë vazhdojnë të fitojnë më pak, të vendosin më pak, dhe të kenë më pak rëndësi se burrat. Ekziston një fushë ku gratë kanë më shumë rëndësi se burrat: në të dhënat mbi viktimat e dhunës".[30]

Barazia gjinore në Kosovë:

Kushtetuta e Republikës së Kosovës shpall ***barazinë gjinore*** si ***vlerë themelore*** për zhvillimin demokratik të shoqërisë kosovare, gjë që përfshin mundësi të barabarta për pjesëmarrje të burrave dhe grave në ***fushat politike, ekonomike, shoqërore, kulturore dhe të tjera të jetës shoqërore***. Kjo pasqyrohet përgjatë tërë Kushtetutën, pasi që ajo parasheh që një sërë institucionesh publike, në përbërjen e tyre, të respektojnë parimet e njohura ndërkombëtarisht të barazisë gjinore, siç është Kuvendi i Kosovës, Shërbimi Civil, gjyqësori, Këshilli Gjyqësor të Kosovës, Prokurori i Shtetit, Këshilli Shtetëror Prokurorial dhe Gjykata Kushtetuese. Përveç kësaj, Kushtetuta gjithashtu parasheh se askush nuk duhet të diskriminohet në bazë të një sërë karakteristikash të mbrojtura, përfshirë gjininë.

Vlera e barazisë gjinore pasqyrohet në një sërë ligjesh dhe politikash të tjera që rregullojnë sfera të ndryshme të jetës, përfshirë:

- Duke njohur **pozitën e pafavorshme të grave** në një shoqëri patriarkale, gjë që vazhdon të ekzistojë në nivel global (shtjelluar më poshtë), dhe Kosova nuk përbën përjashtim nga kjo, **masat afirmative** ose **diskriminimi pozitiv** është identifikuar si një mënyrë për të adresuar pabarazitë gjinore dhe për të filluar së punuari në drejtim të arritjes së barazisë gjinore. Masat afirmative përdoren gjerësisht në sfera të ndryshme të jetës dhe standardi i njohur ndërkombëtarisht në këtë aspekt është 40%. (Kjo i referohet shumës maksimale të një kuote që mund të vendoset me qëllim të përmirësimit të barazisë gjinore në një sferë të caktuar të shoqërisë. Kjo duhet të shfrytëzohet vetëm si një masë e përkohshme, dhe kur të

[30] Sekretari i Përgjithshëm, Thorbjorn Jagland, fjalim me rastin e lansimin e Komisionit të ri të Këshillit të Evropës për Barazi Gjinore, 6 qershor 2012

dëshmohet se qëndrimet kanë ndryshuar, kjo duhet të hiqet nga përdorimi. Në shumicën e rasteve kjo përdoret për të rritur pjesëmarrjen e grave në politikë, por gjithashtu mund të përdoret për të rritur numrin e grave që marrin pjesë në bordet e kompanive publike, si dhe poste të tjera publike ose në pozita mësimdhënieje në universitete.) Në përputhje me këtë standard, të gjitha institucionet publike të Kosovës (legjislativi, ekzekutivi, gjyqësori dhe agjencitë e pavarura në nivel kombëtar dhe lokal) dhe partitë politike janë të detyruara që të vënë në fuqi politika për të mundësuar pjesëmarrjen e barabartë të grave (*Ligji për Barazi Gjinore*).

- Njohjen e **të drejtës së barabartë për arsimim** për meshkujt dhe femrat, në të gjitha nivelet. Përveç kësaj, materialet arsimore duhet të promovojnë barazinë gjinore, duhet të ketë edukim specifik për barazinë gjinore, si dhe përfshirja e meshkujve dhe femrave në profesione të cilat janë konsideruar vetëm për një gjini dhe diskriminimi gjinor janë të ndaluar në të gjitha shkollat dhe institucionet e tjera arsimore (*Ligji për Barazi Gjinore, Ligji për Arsimin Parauniversitar, Ligji për Arsimin e Lartë në Kosovë, Ligji për Arsim dhe Aftësim Profesional*).

- Sa i përket **punësimit**, vendet e lira të punës duhet të shpallen pa specifikuar gjininë. Meshkujt dhe femrat duhet të paguhen **në mënyrë të barabartë për punë të barabartë** dhe t'u ofrohen të njëjtat kushte të punës. Përveç kësaj, duhet të ketë **mundësi të barabarta** për arsimim dhe aftësim profesional që ofrohet nga punëdhënësi. Më tej, ngacmimi dhe diskriminimi në bazë të gjinisë janë të ndaluara. Në kuadër të sektorit të punësimit, gratë kanë të drejtë në pushim të lindjes dhe punëdhënësi nuk ka të drejtë të pyesë një punonjës të ardhshëm në lidhje me planifikimin e familjes së tyre ose t'ia ndërpresë kontratën dikujt për shkak të shtatzënisë. Nëse ndodh një gjë e tillë, kjo do të përbënte diskriminim në bazë të gjinisë, gjë që do të shqyrtohet më tej në Kapitullin mbi Drejtësisë. Ndërsa e drejta e nënës për pushim të lindjes është e njohur marrë parasysh faktin se nëna lind fëmijën dhe mund të ketë nevojë në këtë kohë për t'u shëruar dhe kujdesur për fëmijën, kujdesi për fëmijën ose e rritja e tij/saj nuk është përgjegjësi vetëm e nënës. Për këtë arsye, edhe babai ka të drejtë për **pushim të atësisë** dhe prindërit duhet të jenë në gjendje të bien dakord rreth asaj se kush do të qëndrojë në shtëpi dhe të jetë prindi që kujdeset për fëmijën gjatë zhvillimit të hershëm të tij. Në këtë aspekt, barazia gjinore kërkon që cilido qoftë prind duhet të përmbushë këtë rol dhe se rolet e stereotipat gjinorë nuk duhet të përdoren si bazë për të justifikuar se përse një prind (zakonisht nëna) duhet të jetë ai që qëndron në shtëpi për t'u kujdesur për fëmijën. Çifti ka të drejtë ta rregullojë këtë ashtu siç u përshtaten më së miri rrethanave të tyre, edhe pse ata duhet të jenë të vetëdijshëm se ligji, në një masë të caktuar[31], mundëson që cilido prind ta bëjë këtë dhe se në marrjen e një vendimi të tillë ata (përfshirë nënën) kanë të drejtë të marrin parasysh elemente të ndryshme, si do të ndikojë

[31] Kjo i referohet faktit se babai mund të shfrytëzojë pushimin e atësisë, në vend të pushimit të lindjes së nënës, për 3 muaj pasi nëna të ketë shfrytëzuar 6 muajt e saj. Babai mund të shfrytëzojë pushimin e atësisë vetëm në vend të nënës (6 muajt e parë), nëse nëna vdes ose e braktis fëmijën. Në aspektin e arritjes së barazisë gjinore kuptimplotë, kjo nuk është e përshtatshme dhe në fakt prindërve duhet t'u jepet kjo mundësi për tërë kohëzgjatjen e kësaj periudhe, gjë që është veçanërisht e rëndësishme në një shoqëri patriarkale siç është Kosova. Ju lutemi vini re se kjo mbulohet nga Ligji i Punës, i cili është paraparë të plotësohet-ndryshohet gjatë vitit 2014. Megjithatë, çështjet e përgjithshme janë me rëndësi dhe duhet të diskutohen, pasi që kjo është një nga fushat kryesore që kontribuojnë në ngulitjen e stereotipave gjinorë në shoqërinë kosovare.

koha e qëndrimit në shtëpi në ecurinë e karrierës së saj ose të tij (pasi që po flasim për cilindo prind), etj. (*Ligji për Barazi Gjinore, Ligji i Punës, Ligji kundër Diskriminimit*).

- Obligimin e të gjitha institucioneve financiare për t'u ofruar **qasje të barabartë** (përfshirë të gjitha kushtet dhe kriteret) meshkujve dhe femrave në të gjitha produktet dhe shërbimet e tyre (*Ligji për Barazi Gjinore*).

- Në faktin se nëse gruaja qëndron në shtëpi për t'u kujdesur për fëmijët, atëherë kjo duhet të njihet si kontribut në mirëqenien e familjes, ekonomisë familjare dhe të shoqërisë në tërësi (*Ligji për Barazi Gjinore*).

- Në faktin se në **martesë** bashkëshortët janë të barabartë në raport me të gjitha çështjet personale dhe pronësore. Kjo do të thotë se të dy, si burrat ashtu edhe gratë, kontribuojnë dhe ndajnë të ardhurat dhe pasurinë e tyre të përbashkët. Përveç kësaj, ata janë pronarë të përbashkët zotërojnë pjesë të barabarta të pasurisë së përbashkët, përveç nëse bien dakord ndryshe (gjë që duhet të jetë e zbatueshme, pra që pala të drejtat e së cilës do të preken duhet të ketë kërkuar këshilla juridike). Fusha të tjera të rëndësishme përfshijnë vendosjen në lidhje me mbiemrin e tyre të përbashkët, dhe edhe në këtë rast ata duhet të vendosin së bashku lidhur me mbiemrin martesor. Nëse nuk mund të pajtohen mbi një mbiemër të përbashkët, atëherë ata mbajnë mbiemrat e tyre. Ngjashëm, ata vendosin bashkërisht për mbajtjen e ekonomisë së përbashkët familjare (*Ligji për Familjen*).

- Në faktin se burrat dhe gratë kanë **të drejta të barabarta në trashëgimi**: kjo është si në raport me bashkëshortët, ashtu edhe fëmijët e tyre. Pra, në martesë gruas i njihet e drejta në trashëgimi (siç është përshkruar më sipër), dhe sa u përket fëmijëve, ata kanë të drejta të barabarta në trashëgimi, pavarësisht gjinisë (*Ligji për Trashëgiminë në Kosovë*).

- Në përgjegjësinë e **mediave** (të shkruara dhe audio-vizuale) që jo vetëm të sigurojnë që personeli i tyre përfaqëson të dyja gjinitë, por edhe që të promovojnë barazinë gjinore duke sfiduar praktikat dhe stereotipat tradicionalë në programet e tyre, qoftë nëse i dedikohen barazisë gjinore ose janë të tjerë (*Ligji për Barazi Gjinore*).

- Në faktin se në rast se një **grua sulmohet në shtëpi** (fizikisht, përfshirë seksualisht, ose pëson abuzim psikologjik), si bashkëshorte, nënë apo e bijë, kjo trajtohet si kundërvajtje e ashpër dhe autoritetet e zbatimit të ligjit janë të detyruara që të trajtojnë çdo raport në mënyrë adekuate duke i ofruar çdo viktime, pavarësisht gjinisë ose përkatësisë etnike, ndihmën e nevojshme. Në rast se përgjigjja është joadekuate, për shkak të pikëpamjeve tradicionale ose stereotipave, d.m.th. se një grua nuk duhet të raportojë bashkëshortin e saj për rrahje ose të faktit se kjo është çështje private familjare në të cilën shteti nuk duhet të përfshihet, kjo përbën diskriminim gjinor (*Kodi Penal i Kosovës, Ligji mbi Dhunën në Familje, Ligji kundër Diskriminimit*).

Barazia gjinore në realizim e sipër: gjendja në terren

Hulumtimet nga raportet e ndryshme tregojnë si në vijim:

Punësimi[32]:

- Ndërmarrjet publike janë të detyruara të sigurojnë punësim në mënyrë të barabartë për burrat dhe gratë; e megjithatë, bazuar në të dhënat, ato nuk kanë shënuar rezultate veçanërisht pozitive:

Institucioni / Kompania	Meshkuj	Femra	Niveli i vendimmarrjes			
			Meshkuj		Femra	
KEK[33]	93% (7,804)	7% (573)	89% (32)		11% (4)	
PTK[34]	76% (2560)	24% (794)	76% (312)	89%[35] (65)	24% (99)	11%[36] (8)
Spitalet	32%	68%	/		/	
Këshilli Gjyqësor i Kosovës	61% (35)	39% (29)	84% (10)		16% (2)	
Gjykatat	72% (157)	28% (69)	/		/	
Shkollat	59% (16,167)	41% (11,387)	/		/	
Radiotelevizioni i Kosovës	68% (355)	32% (162)	/		/	

Një tjetër fakt me rëndësi:

2005: mbi 75% e grave të anketuara (2005) kanë thënë se nuk janë të punësuara dhe nuk kanë të ardhura personale. Në anën tjetër, vetëm 19.2% kanë thënë të jenë të punësuara me orar të plotë.[1]

Fusha të tjera ku ka mungesë të barazisë gjinore:

Emrat e vendeve publike	Meshkuj	Femra
Shkollat e mesme	98% (566)	2% (10)
Kolegjet/gjimnazet	83% (73)	17% (15)

[32] Shihni raportin nga NORMA, 'Hulumtimi dhe monitorimi i zbatimit të Ligjit për Barazi Gjinore', 2010, në dispozicion në http://www.norma-ks.org/repository/docs/norma_alb_(10)_(1).pdf, qasur më 20/04/2014
[33] Korporata Energjetike e Kosovës – statistika të vitit 2010
[34] Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës – statistika të vitit 2010
[35] Kjo u referohet pozitave menaxheriale
[36] Poaty

Emrat e rrugëve në Prishtinë	97%	3%

Trashëgimia[37]:

- 40.83% e 1,050 grave të anketuara kanë thënë se ndonëse trashëgimia është e rregulluar me ligj, kjo çështje faktikisht zgjidhet sipas traditës dhe zakoneve;
- 41.5% e të anketuarave kanë thënë se prona e tyre është e regjistruar në emrin e bashkëshortëve të tyre;
- 19.87% e femrave të pamartuara kanë thënë se prona është e regjistruar në emër të babait të tyre, ndërsa 19.7% e grave të martuara kanë thënë se prona e tyre është e regjistruar në emrin e të etërve ose bashkëshortëve të tyre.
- 54.9% e femrave i janë referuar trashëgimisë duke pasur parasysh vetëm tokën;
- 43.6% e femrave kanë deklaruar se një nga arsyet kryesore për mungesën e trashëgimisë është mohimi i të drejtave të tyre, ndërsa 29.2% mendojnë se ekziston frika e tjetërsimit nëse kërkojnë trashëgiminë e tyre dhe e marrin me vete në familjet e bashkëshortëve të tyre;
- 75.5% e femrave mendojnë se trashëgimia duhet t'u jepet të gjithë fëmijëve, pavarësisht gjinisë, edhe pse 21.4% e tyre mendojnë se ajo duhet të trashëgohet vetëm nga meshkujt;
- 29.96% kanë deklaruar se kur marrin vendime për trashëgiminë nuk e shohin këtë nga perspektiva materiale, por më tepër nga ajo shpirtërore;
- 19.6% kanë deklaruar se preferojnë t'ua lënë trashëgiminë vëllezërve të tyre për shkak të natyrës tradicionale të sistemit të familjes në Kosovë, ndërsa 7.21% besojnë se djemtë duhet të jenë ata që trashëgojnë.

Gratë në Kosovë gjithashtu kanë frikë nga pasojat e kërkimit të të drejtave të tyre për trashëgimi. 31.3% kanë thënë se kanë frikë se do të injoroheshin ose gjykoheshin nga të afërmit ose anëtarët e familjes, 30.3% mendojnë se në përpjekje për të realizuar këtë të drejtë do të pengoheshin nga anëtarë të familjes si vëllezërit e tyre. Për më tepër, 10.91% mendojnë se kjo çështje do të kapërcehet në heshtje.

[37] Shihni raportin e Qendrës Kosovare për Studime Gjinore, 'Të drejtat e grave në trashëgimi të pronave në Kosovë', 2011, në dispozicion në https://dl.dropboxusercontent.com/u/55888602/kgscPublications/Shqip/EdrejtaeTrash%C3%ABgimise.pdf, qasur më 20/04/2014

Arsimimi[38]:

- Më 2005 është raportuar se vetëm 15.8% e femrave kanë vazhduar shkollimin pas përfundimit të shkollës së mesme.
- Megjithatë, sipas regjistrimit të fundit, të vitit 2011, gjenjda është si në vijim:

Niveli i arsimimit	Meshkuj	Femra
Gradë Bachelor	45,789	29,424
Gradë Master	5,984	2,811
Doktoraturë (PhD)	1,108	228

Votimi[39]:

Gratë në Kosovë janë votuese të vazhdueshme, dhe mbi 2/3 kanë votuar për të njëjtën parti;
Gratë që jetojnë në zonat urbane ka më shumë të ngjarë që të ndryshojnë preferencat e tyre e tyre të votimit se sa ato në zonat rurale;
Familja ushtron njëfarë presioni mbi gratë në lidhje me atë se për kë duhet të votojnë, por shumica e të anketuarave kanë pohuar se nuk është kështu;
Shumica dërrmuese e grave nuk janë anëtare të ndonjë partie politike;
Gratë kanë pak informata në lidhje me të drejtat e tyre ligjore dhe kushtetuese;
Burimi kryesor i informatave për gratë është televizioni;
Mbi 40% e grave nuk e dinë kujt i raportoni liderët institucionalë dhe kjo është e dukshme në mesin e grave në zonat rurale, ku shumica nuk e dinë këtë; dhe
Gratë kanë pak ose aspak informata në lidhje me punën e politikaneve femra në Kosovë.

Pjesëmarrja politike[40]	**Femra**	**Meshkuj**
Presidentë (të gjithë)	1	5
Kryeministra (të gjithë)	0	6
Zëvendëskryeministra	1	4
Ministra	1	17
Zëvendësministra	1	34
Misione jashtë vendit	6	16
Deputetë të kuvendit nacional	40	80

[38] Shihni raportin e Qendrës Kosovare për Studime Gjnore, 'Si votojnë gratë në Kosovë', 2005, në dispozicion në https://dl.dropboxusercontent.com/u/55888602/kgscPublications/Publikimet1/1.%20HowdoWomenVoteinKosova.pdf, qasur më 20/04/2014

[39] Poaty

[40] Farnsveden U, Qosaj-Mustafa A, Farnsworth N, 'Profili gjinor i vendit – Kosovë', 2014

Kryesues të Komisioneve Parlamentare	1	8
Kryetarë të Komunave	1	32
Drejtorë të Drejtorive Komunale	4.4%	94.6%
Anëtarë të Kuvendeve Komunale	34%	66%
Shërbimi Civil	38%	60%

Pikëpamjet e nxënësve në shkolla në Kosovë rreth barazisë gjinore[41]:

- 95.8% e të anketuarve (1,700) kanë thënë se besojnë se meshkujt dhe femrat duhet të kenë mundësi të barabarta për të marrë pjesë në shoqëri;
- 95.2% e të anketuarve gjithashtu kanë thënë se besojnë se meshkujt dhe femrat duhet të kenë të drejta të barabarta;
- 9, 22.9% e të anketuarve janë pajtuar femrat duhet të qëndrojnë jashtë politikës, nga të cilët të anketuar 15.5% kanë qenë femra;
- 42.2% janë pajtuar me deklaratën se meshkujve duhet t'u jepet prioritet për vende pune në krahasim me femrat, kur nuk ka vende të mjaftueshme pune, nga të cilët të anketuar 34% kanë qenë femra.

Fushat në të cilat gratë në Kosovë mund të përballen me pabarazi::

- **Arsimimi**: vajzat edhe më tej nuk shikohen njëjtë si djemtë kur bëhet fjalë për arsimin, ka prirje që vajzat të nënvleftësohen, në disa familje është shumë më e rëndësishme që vajzat të jenë të nderuara, të sillen mirë, të dinë si të respektojnë e të kujdesen për familje sesa të jenë të arsimuara. Në fakt, në një pjesë të caktuar të shoqërisë, të qenit i arsimuar dhe dëshira për të ndryshuar rolet e ngulitura gjinore, të cilat janë diskriminuese brenda familjes, mund të shihet si mungesë respekti;
- **Kujdesi shëndetësor**: femrat vazhdojnë të përballen me norma më të larta të vdekshmërisë, ka mundësi të mos kenë qasje në kontracepsion ose në forma të tjera të mbrojtjes që mundësojnë seks të sigurt;
- **Punësimi**: femrat vazhdojnë ta kenë më të vështirë që të hyjnë në tregun e punës;
- **Paga të barabarta për punë të barabartë**: fenrat paguhen më pak për të bërë të njëjtën punë si burrat, gjë që ka të bëjë me perceptimin, pasi që në shumë shoqëri ato nuk shihen si shtylla e familjes;
- Femrat mund të mos kenë të njëjtat **mundësi** në aspektin e ngritjes në karrierë, arsimimit dhe trajnimeve profesionale;
- Gjatë rekrutimit ka mundësi që gratë të pyeten në lidhje me planifikimin familjar në mënyrë që punëdhënësi të mos paguajë **pushimin e lindjes** ose gjatë shtatzënisë punëdhënësi mund t'ua ndërpresë kontratën;

[41] Shihni raportin e Qendrës për Arsim të Kosovës, 'Hulumtim mbi konceptet e qytetarisë te nxënësit në Kosovë', prill 2014

- Nuk ka shumë raste kur kujdesi ndaj fëmijëve është i përbashkët për të dy bashkëshortët dhe nuk është shumë e zakonshme që etërit të zgjedhin pushim më të gjatë atësisë për t'u mundësuar nënave që t'i kthehen karrierës. Përveç kësaj, pushimi fillestar i atësisë nuk mund të shfrytëzohet nga babai, përveç nëse nëna braktis fëmijën ose vdes. Mund të argumentohet se kjo përbën një vazhdimësi të stereotipave gjinorë që ekzistojnë në shoqëri, ku është përgjegjësi e nënës që të kujdeset për fëmijën. Në mënyrë që të ketë barazi gjinore kuptimplote, të dy prindërit duhet të njihen si përgjegjës për të gjitha nevojat e fëmijës.
- Kontributi që japin gratë në shtëpi nuk njihet gjerësisht, veçanërisht në rastet kur ato nuk kanë të ardhura të tjera;
- Sigurimi i respektit për jetën e tyre private:
    - ✓ ka mundësi të pritet që kur femrat të martohen të jetojnë me familjen e bashkëshortit, siç janë prindërit e tij, gjë që mundëson që rolet e ngulitura gjinore të vazhdojnë të mbizotërojnë dhe në masë të madhe të ndikojnë në jetën e tyre private, d.m.th. anëtaret femra të familjes i 'këshillojnë' gratë se çka duhet të veshin dhe si duhet të flasin me anëtarët e tjerë të familjes;
    - ✓ ka mundësi që gruaja të mos jetë e lirë të vendosë se ku të shkojë dhe kur, dhe ka mundësi që t'i kërkohet të pyesë bashkëshortin, vjehrrit ose familja e tij të gjerë;
    - ✓ ka mundësi që një gruaje të mos i lejohet të dalë vetëm, pra mund të shprehet pakënaqësi ndaj saj nëse merr taksi vetëm ose shfrytëzon transportin publik, kështu që ajo duhet të jetë e shoqëruar nga dikush ose një anëtar i familjes ose nga një fëmijë i saj;
    - ✓ ka mundësi që të mos jetë e pranueshme që ajo të dalë natën me miq/mikesha, pasi që, qoftë femër e re ose e martuar, ajo duhet të sigurohet që të ruajë nderin;
    - ✓ ajo mund të jetë e punësuar, por puna e saj nuk konsiderohet aq e rëndësishme sa puna e bashkëshortit dhe mund të mos i lejohet të ketë xhirollogarinë e saj bankare ose të ketë nën kontroll paratë që fiton: mund t'i kërkohet që çdo muaj t'ia dorëzojë paratë vjehrrës ose bashkëshortit dhe ata të vendosin se si të shpenzohen ato;
- **Qasja në hua bankare** dhe forma të tjera të kredive për nisjen e bizneseve të reja: femrat nuk shihen si klientë potencialë nga ana e institucionet financiare dhe produktet e tyre nuk i kanë ato për objektiv. Nga ana tjetër, kur aplikojnë për kredi, ka prirje që të përballen me pikëpamje stereotipash dhe madje me diskriminim;
- **Trashëgimia**, përfshirë **të drejtat pronësore**: femrat akoma nuk shihen si të barabarta me burrat në lidhje me të drejtën e tyre për të trashëguar pronë ose lloje të tjera pasurish nga baballarët e tyre. Në shumë familje, femrave u 'ofrohet' një pjesë të vogël, të cilën pritet t'ua lënë vëllezërve të tyre. Shumë rrallë ndodh që trashëgimia të ndahet në mënyrë të barabartë dhe në fakt t'u jepet si e tillë. Ngjashëm, ka mundësi që gratë të mos jenë të regjistruara si zotëruese të pronës së përbashkët me bashkëshortët e tyre dhe kjo më vonë mund të shkaktojë vështirësi në aspektin e trashëgimisë, ose ato mund të përballen me presion nga familja e zgjeruar e bashkëshortit për të mos e kërkuar këtë trashëgimi në rastet kur bëhen të veja.
- **Politika**: edhe pse përmes **kuotës prej 30%** për zgjedhje është menduar që të arrihet që më shumë gra të marrin pjesë në jetën publike, kjo nuk është madje as në përputhje me standardet ndërkombëtare (40%) dhe deri më tani nuk ka është arritur aq shumë sa që të ndryshojnë qëndrimet. Në shumë raste, zgjedhja e këtyre grave nga ana e partive politike

bëhet nga njerëz që dominojnë partitë dhe të cilët kështu i kontrollojnë ato, duke siguruar kështu që t'i përmbahen vijës së partisë. Ndërsa është evidente se kuota duhet të mbetet, pasi që nuk i ka shërbyer qëllimit të saj, duhet bërë më shumë për të siguruar që pikëpamjet stereotipike për gratë ndryshojnë. Është pozitive që Presidentja është femër, si dhe që kohët e fundit Kosova e ka Kryetaren e parë femër të një Komune. Megjithatë, edhe këto ndryshime janë të vogla dhe nuk ndikojnë aq shumë sa që të ndryshojnë qëndrimet. Kjo për shkakun se Kosova mbetet shoqëri patriarkale dhe femrat akoma nuk shihen se janë në gjendje të kontribuojnë në vende të punës të dominuar nga meshkujt. Për shembull, një studim i KEC-it, i vitit 2014, ka zbuluar se femrat e reja besojnë se duhet të qëndrojnë jashtë politikës, pasi që aty nuk ka vend për to. Kjo është veçanërisht problematike pasi që nëse vajzat e reja nuk do të fillojnë të mendojnë që të duan të bëhen Presidente apo Kryeministre, por të mendojnë se këto janë role për djem, atëherë do të nevojitet një kohë të gjatë që këto qëndrime të ndryshojnë.

- **Mediat**: gazetat dhe televizionet i japin hapësirë barazisë gjinore deri në njëfarë mase; megjithatë, kjo nuk është çdoherë e dobishme. Në veçanti, stacione të caktuara televizive kanë filluar të transmetojnë programe ku gratë ftohen për të folur rreth një çështjeje të caktuar. Ndërsa jo-formalitetit përbën një aspekt pozitiv, mund të argumentohet se kjo është e tepruar, pasi që programet e ndryshme që udhëhiqen nga femra priren të fokusohen në çështjet e grave, të cilave në fakt nuk kanë kurrfarë substance dhe forcojnë stereotipat gjinorë.

Përse është pabarazia gjinore aq e ngulitur/çfarë na tregon historia?

Citate të famshme, por për keqardhje, që tregojnë se pabarazia gjinore ka një histori të gjatë:

"Gruaja duhet të jetë e mirë për gjithçka në shtëpi,
por e mirë për asgjë jashtë." — Euripidi (480/85–406 P.K.)

"Të gjitha gjërat që i kërkojnë burrat janë gjëra që i kërkojnë edhe gratë, por në të gjitha gratë janë inferiore ndaj burrave." —Platoni (428/27–348/47 P.K.)

"Gratë duhet të qëndrojnë në shtëpi, të rrinë rehat,
të kujdesen për shtëpinë dhe për fëmijët" —Martin Lutheri (1483–1546)

"Zëri i saj ishte më këndshmi, / I butë, dhe i ulët,— diçka e mrekullueshme për një grua."
"Mos lejoni që armët e grave, si pika uji, / Të mbesin si njollë në faqet e burrit tim!"
—William Shakespeare (1564–1616)

"Shumica e grave nuk kanë fare karakter."
"Burrat, disa merren me biznes, disa ndjekin kënaqësitë; /
Por çdo grua në zemër është e pacipë."
**I/e pacipë është dikush që sillet në mënyrë të pamoralshme]*

—Alexander Pope (1688–1744)

"Zotëri, një grua që predikon është si një qen që ec
me këmbët e pasme. Punë që s'bëhet si duhet;
por mahnitesh kur
e zbulon që bëhet fare."
—Samuel Johnson (1709–1784)

"Natyra ka dashur që gratë të jenë skllavet tona. Ato janë pronë…*
Gratë nuk janë asgjë përveç se makina për të prodhuar fëmijë."
—Napoleon Bonaparte (1769–1821)

"Shikojeni shoqërimin e grave si
pakëndshmëri të domosdoshme të jetës në shoqëri,
dhe shmangni ato sa më shumë që të mundeni."
—Leon Tolstoi (1828–1910)

"Asnjë grua nuk është gjeniale; gratë janë gjini dekorative."

—Oscar Wilde (1854–1900)

Shkrimtaret – a kanë ekzistuar gjatë të njëjtës periudhë?

Femrat nuk janë po aq të dukshme dhe të famshme në historinë e botës sa burrat, por kjo nuk nënkupton se ato nuk kanë qenë të pranishme.

Emrat e shkrimtareve	Periudha	Publikimet/veprat
Mary Wollstonecraft	1759 – 1797	Ajo ka shkruar për arsimim, udhëtime, histori, politikë dhe të drejtat e grave. Më e njohura për: ***'A Vindication of the Rights of Women'*** **(**shq. ***'Në mbrojtje të të drejtave të grave'), 1792***.
Hannah Adams	1755 – 1831	Shkrimtarja e parë profesionale në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Ajo ka shkruar në mbështetje të vetvetes për tema të ndryshme si teologjia dhe historia, përfshirë: ***'Summary History of New England' (***shq. ***'Histori e përmbledhur e Anglisë së Re')*** (1799). Kjo është historia e parë që gjurmon SHBA-të nga Mayflower deri në

		ratifikimin e Kushtetutës federale.
Frances Burney	1752 – 1840	Frances Burney ka qenë romanciere e dramaturge dhe ka shkruar ditarë. Ajo ka botuar romanin e saj të parë, ***Evelina***, me autore anonime, më 1778. Pas këtij ka botuar vepra të tjera, si *Cecilia* (shq. *Sesilia*) (1782), *Camilla* (shq. *Kamilla*) (1796) dhe *The Wanderer* (shq. *Bredharakja*) (1814). Sapo kishte dalë publikisht si autore e *Evelina*, kjo i kishte sjellë famë të menjëhershme. I përshkruar më 1778 si roman që shikonte të qenit grua me humor, ky është romani më i lexuar i Burneyt në ditët e sotme. Chick lit
Jane Austen	1775 – 1817	Jane Austen ka qenë romanciere librat e së cilës kanë pasur për tematikë klasën e mesme dhe të lartë angleze. Ata shquhen për zgjuarsi dhe njohuri depërtuese që ofrojnë në lidhje me jetën e grave në shekullin XIX. Ajo ka botuar katër romane derisa ishte gjallë, ndonëse janë botuar pa emrin e saj dhe zakonisht autorësia e tyre u atribuohet 'një zonje'. Këto libra janë: ***Sense and Sensibility (***shq. ***Ndjenja dhe ndjeshmëri) (1811)***, ***Pride and Prejudice*** (shq. ***Krenari dhe paragjykime***) ***(1813), Mansfield Park*** (***Parku Mansfield***) ***(1814)*** dhe ***Emma*** (***Ema***) ***(1816)***.
Kate Chopin	1851 – 1904	Ajo kishte filluar të shkruante pasi i kishte vdekur bashkëshorti dhe ishte e detyruar të mbante veten dhe 6 fëmijët e saj të cilët i kishte lindur deri në moshën 28-vjeçare. Ajo ka shkruar tregime të shkurtra, si lla si ***Bayou Folk (1894)***, me të cilin është bvrë e njohur në tërë Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Megjithatë, ajo më vonë botoi një roman kundërthënës, tani të vlerësuar në mënyrë kritike, me titullin ***'The Awakening'*** (shq. ***'Zgjimi'***) (1898), i cili trajton pavarësinë e femrës përmes një heroine e cila lë bashkëshortin dhe fëmijët e saj për të zbuluar lirinë personale. Në vitin 1990 ajo u nderua me një yll në Shëtitoren e Famës në St. Louis dhe më 2012 me një bust prej bronzi në Këndin e Shkrimtarit në St. Louis, Misuri, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.
Maria Edgeworth	1767 – 1849	Me inkurajimin e babait të saj, Maria Edgeworth kishte shkruar fillimisht tre libra për fëmijë, si dhe romane për të rritur. Shumica e romaneve të saj fokusoheshin në jetën e zakonshme irlandeze, përfshirë *Castle Rackrent* (shq. *Kalaja Rackrent*) (1800), *Ennui* (shq. *Mërzi*) (1809), *The Absentee* (shq. *E munguara*) (1812), *Ormond* (1817). Në shkrimet e saj ajo trajton barazinë gjinore dhe shpesh

		paraqet gruan si personazh kryesor. Ajo gjithashtu kishte shkëmbyer letra me shkrimtarë kryesorë letrarë dhe të ekonomisë si Sir Walter Scott dhe David Ricardo.
Motrat Brontë **Charlotte Brontë** **Emily Brontë** **Anne Brontë**	 1816 – 1855 1818 – 1848 1820 - 1849	Motrat Brontë kishin botuar një përmbledhje të poezive më 1846, tw cilin e kishin shkruar nën pseudonimin Currer, Ellis dhe Acton Bell. Charlotte gjithashtu kishte shkruar ***'The Professor'*** (***'Profesori'***), e cila ishte refuzuar kur ishte dërguar për botim, ndonëse ishte botuar më vonë. Megjithatë, një vit më vonë, më 1847, të tri motrat kishin botuar romane nën pseudonimin e mësipërm: Charlotte/Currer Bell kishte botuar ***'Jane Eyre'***; Emily/Ellis Bell kishte botuar ***'Wuthering Heights'*** dhe Anne / Acton Bell kishte botuar ***Anne Grey'***. Më 1848 kishin shkuar për të takuar botuesin për të zbuluar identitetin e motrave Bell, gjw qw e kishte habitur botuesin, pasi që ai i kishte menduar ato si tre gra të thjeshta fshatare.
Harriet Beecher Stowe[42]	1811 – 1896	Harriet Beecher Stowe ka shkruar shumë romane, si dhe prozë letrare dhe të bazuar në ngjarje reale. Ajo është më së shumti e njohur për romanin e saj kundër skllavërisë '***Uncle Tom's Cabin'*** (***'Kasollja e Xha Tomit'***) (1852), i cili u bë ndër librat më të shitur, duke i sjellë si lëvdata të mëdha ashtu edhe kritika të ashpra. Thuhet se kur e kishte takuar ***Presidentin Abraham Lincoln, më 1862***, ai i kishte thënë ***'domethënë ti je ajo gruaja e vogël që ka shkruar librin që nisi këtë Luftë të Madhe'***. Ky libër nuk ishte shkaku i vetëm i luftës, por kishte ndezur opinione kundër dhe pro skllavërisë në të cilat besonin Veriu dhe Jugu dhe që kishte çuar në Luftën Civile.
Virginia Woolf	1882 – 1941	Virginia Woolf konsiderohet njëra nga romancieret moderne më preeminente. Ajo kishte filluar të shkruante profesionalisht në vitin 1900 dhe ka botuar një numër romanesh e esesh. Ajo është e njohur si romancierja kryesore lirike e gjuhës angleze dhe është krahasuar me James Joycein për sa i përket eksperimentimit me rrëfime dhe rrjedhën e ndjenjave në romanet e saj. Në ***A Room of One's Own'*** (shq. ***'Një dhomë për vete'***) (1929), ajo shkëlqyeshëm kishte pohuar se, në mënyrë që të shkruajë, ***një grua ka nevojë për të ardhura të vetat dhe në dhomë të veten.***

[42] Më tepër informata në dispozicion në: https://www.harrietbeecherstowecenter.org/pdf/hbs_bio.pdf, qasur më 10/04/2014

Louisa May Alcott	1832 – 1888	Louisa May Alcott kishte filluar të shkruante për të ndihmuar familjen e saj, të cilët përballeshin me vështirësi financiare. Fillimisht ajo përdorte pseudonimin e saj, A.M. Barnard, edhe pse më vonë kishte botuar me emrin e saj të vërtetë. Ajo ka publikuar një numër romanesh, edhe pse është e njohur më së shumti për ***'Little Women'*** (shq. ***'Gratë e shkurtra'***).
Simone de Beauvoir	1908 – 1986	Simone de Beauvoir ishte njëra nga filozofet dhe shkrimtaret më preeminente ekzistencialiste franceze. Ajo ka shkruar mbi etikën, feminizmin, prozë letrare, autobiografi dhe për politikë. Ajo ka botuar '***The Ethics of Ambiguity'*** (shq. ***'Etika e dykuptimësisë'***), '***The Manadrins***'(shq. ***'Mandarinët'***) dhe '***The Second Sex***' (shq. ***'Gjinia e dytë'***). Tek ***'Gjinia e dytë'***, ajo kishte sulmuar në mënyrë elokuente faktin se gratë ishin shtyrë në një sferë të 'imanencës' dhe në pranimin pasiv të roleve që u janë caktuar. Si tekst, ky libër është shfrytëzuar si bazë nga revolucioni feminist dhe për nevojën për të hulumtuar shtypjen e grave dhe demaskimin e këtij fenomeni.

<u>Shkrimtaret e njohura moderne:</u>

Emri	Periudha kohore	Botimet/veprat
Margaret Attwood	1939 -	Poete dhe romanciere kanadeze: ka botuar shumë romane, poezi dhe tregime të shkurtra.
Alice Walker	1944 -	Autore amerikane: ka shkruar veprën e vlerësuar në mënyrë kritike *The Purple Color* (shq. *Ngjyra e purpurt*), për të cilin ka fituar Çmimin Kombëtar të Librit (*National Book Award*) dhe Çmimin Pulitzer për prozë letrare.
Toni Morrison	1931 -	Romanciere amerikane: ka shkruar shumë romane, përfshirë 'Beloved' (shq. 'E dashur'), me të cilën fitoi Çmimin Pulitzer më 1988 dhe Çmimin Nobel më 1993 Asaj i është akorduar Medalja Presidenciale e Lirisë.
Joyce Carol Oates	1938 -	Autore amerikane, e cila ka botuar mbi 40 romane, tregime të shkurtra dhe poezi.

Isabel Allende	1942 -	Shkrimtare kiliane: ka shkruar romane, në të cilat u bëhet nder grave, përmes elementeve të mitit dhe realizmit.
Sylvia Plath	1932 - 1963	Poete e romanciere amerikane, dhe shkrimtare e tregimeve të shkurtër: ajo ka shkruar shumë poezi për të cilat ka fituar Çmimin Pulitzer, pas vdekjes, për ***'The Collected Poems'*** (shq. ***'Përmbledhje poezish'***).
J.K. Rowling	1965 -	Romanciere britanike, më e njohura për serinë e prozës letrare *Harry Potter*.

<u>Shkrimtaret nga Ballkani</u>

Emri	Periudha kohore	Botimet/veprat
Musine Kokollari	1917 - 1983	Prozatore dhe politikane në Shqipëri para komunizmit, e cila ishte persekutuar nga regjimi komunist. Ajo ka shkruar një përmbledhje tregimesh, të titulluar **'Seç më thotë nëna plakë'.**
Mira Meksi	1960 -	Shkrimtare dhe përkthyese shqiptare, e cila ka shkruar shumë romane dhe ka fituar çmime të ndryshme. Një nga romanet e saj është **"Porfida, një ballo në Versajë"**.
Besa Myftiu	1961 -	Shkrimtare shqiptare e cila ka shkruar në frëngjisht dhe ka botuar **"Des amis perdus"** (shq. **"Miq të humbur"**) dhe romane, përfshirë **"Confessions of Missing Places"** (shq. **"Rrëfime nga vendet e harruara"**)
Elena Gjika	1822 - 1829	Shkrimtare dhe botuese me origjinë shqiptare. Ka shkruar shumë libra, përfshirë **"Les Femmes en Orient"** (shq.

		"Gratë në Orient") dhe **"Shqiptarët në Rumani"**, mes tjerash**.**
Jelena Dimitrijevic	1862 - 1945	Shkrimtare e shquar serbe, e cila ka udhëtuar gjerësisht dhe ka shkruar mbi përvojat e saja, përfshirë mbi udhëtimet e saj në Greqi, Indi, Egjipt dhe Amerikë.
Marija Knezevic	1963	Shkrimtare serbe, e cila ka shkruar shumë poezi, romane dhe tregime të shkurtra.
Isidora Sekulic	1877 - 1958	Prozatore, romanciere dhe eseiste serbe.
Milica Stojadinovic	1828 - 1878	Poete serbe e shekullit XIX.
Svetlana Velmar-Jankovic	1933 - 2014	Eseiste dhe romanciere serbe.

Fitueset femra të Çmimit Nobel për Letërsi: 1901 – 2013

Çmimi Nobel:

Alfred Nobel ka qenë kimist e novator suedez dhe prodhues armësh. Ai ka marrë një numër patentash në prodhimin e armatimit, përfshirë për dinamit. Më 27 nëntor 1895, Alfred Nobel kishte nënshkruar testamentin e tij, ku kishte shkruar dëshirat e tij të fundit, përmes së cilës kishte kërkuar që një pjesë e madhe e pasurisë së tij të shfrytëzohet për cmime të ndryshme. Kështu u krijua Çmimi Nobel për Fizikë, Kimi, Fiziologji ose Mjekësi, Letërsi dhe Paqe. Më 1968 Banka Qendrore Suedeze krijoi Çmimin për Ekonomi, në kujtim të Alfred Nobelit. Gjatë viteve 1901-2013, Çmimet Nobel dhe Çmimi Ekonomi janë dhënë 561 herë.[43]

Fitueset e Çmimit Nobel për Letërsi:

Emri	Viti	Botimet/veprat
Slema Ottilia Lovisa Lagerlof	1909	Autore suedeze e librave për fëmijë dhe femra e parë që ka fituar Çmimin Nobel, me veprën '***The Wonderful Adventure of Nils'*** (shq. ***'Aventura e mrekullueshme e Nilsit'***)

[43] Më tepër hollësi në dispozicoion në http://www.nobelprize.org/nobel_prizes/facts/, qasur më 20/04/2014

Grazia Deledda	1926	Femra e parë italiane që ka marrë Çmimin Nobel për veprën e saj.
Sigrid Undset	1928	Romanciere norvegjeze, e cila ka fituar Çmimin Nobel Prize për veprat ***'Kirstin Lavransdatter'*** dhe '***Mjeshtri i Hestvikenit'***. '***Kirstin Lavransdatter'*** kishte për tematikë jetën në Skandinavi në mesjetë, të portretizuar nëpërmjet përvojës së një gruaje.
Pearl Buck	1938	Romanciere amerikane, e cila ka fituar Çmimin Pulitzer më 1932 me romanin 'The Good Earth' ('Toka e mirë'), në të cilën portretizohej jeta fshatare në Kinë. Ajo ka fituar Çmimin Nobel për Letërsi më 1938.
Gabriela Mistral	1945	Poete/diplomate kiliane: ishte femra e parë latino-amerikane që kishte fituar Çmimin Nobel për Letërsi.
Nelly Sachs	1966	Poete dhe dramaturge hebreje nga Gjermania. Më 1996 ishte fituesja e Çmimit Nobel për Letërsi së bashku me Shmuel Yusuf Agnonin. Siç thuhet, ajo kishte deklaruar se Agnon përfaqësonte shtetin e Izraelit, ndërsa ajo tragjedinë e popullit hebre.
Nadine Gordimer	1991	Shkrimtare jugafrikane, e cila ka publikuar vepra rreth aparteidit në Afrikën Jugore, të cilat kanë qenë të ndaluara për disa vite.
Toni Morrison	1993	Romanciere amerikane – shihni më sipër.
Wislawa Szymborska	1996	Poete polake, e cila ka fituar Çmimin Nobel për Letërsi më 1996.
Elfriede Jelinek	2004	Dramaturge dhe romanciere austrike, e cila kishte fituar Çmimin për Letërsi më 2004.
Doris Lessing	2007	Dramaturge, romanciere, poete dhe shkrimtare e tregimeve të shkurtra nga Britania. I është dhënë Çmimi Nobel për Letërsi më 2007, duke u bërë personi më i vjetër që ka fituar këtë Çmim.
Herta Muller	2009	Romanciere dhe poete gjermano-rumune, e cila ka fituar Çmimin Novel për Letërsi më 2009. Në deklaratën e Komitetit të Çmimit Nobel ishte thënë se ajo përshkruan mjedisin e atyre që u janë mohuar të drejtat.
Alice Munro	2013	Autore kanadeze e tregimeve të shkrutra.

Laureatet e Çmimit Nobel në fusha të tjera[44]:

Fizikë		
Maria Goper Mayer	1963	Zbulime në lidhje me strukturën e guaskës bërthamore
Marie Curie	1903	Hulumtime rrugëçelëse mbi radioaktivitetin
Kimi		
Ada E. Yonath	2009	Studime të strukturës dhe funksionit të ribozomit
Dorothy Crowfoot Hodgkin	1964	Përcaktimi përmes teknikës së rrezeve X të strukturave substancave të rëndësishme biokimike
Irene Joliot-Curie	1935	Sintezë e elementeve të reja radioaktive
Marie Curie	1911	Në shenjë njohjeje për shërbimet e saj për avancimin e kimisë përmes zbulimit t elementeve radioaktive
Fiziologji/Mjekësi		
Elisabeth H. Blackburn and Carol W. Greider	2009	Zbulimi i mënyrës se si mbrohen kromozomet nga telomerët dhe enzima telomeraz
Françoise Barré-Sinoussi	2008	Zbulimi i virusit të mungesës së imunitetit njerëzor
Linda Buck	2004	Zbulimi i receptorëve të nuhatjes dhe organizimit të sistemit të nuhatjes
Christiane Nusslein-Volhard	1995	Zbulim mbi kontrollin gjenetik të zhvillimit të hershëm embrional
Gertrude B. Elion	1988	Zbulimi i parimeve të rëndësishme për trajtim me barna
Rita Levi-Montalcini	1986	Zbulimi i faktorëve të rritjes


[44] Për më tepër hollësi mbi Çmimet Nobel të fituara nga femrat, shihni http://www.nobelprize.org/nobel_prizes/lists/women.html, qasur më 20/05/2014


Barbara Mclintock	1983	Zbulimi i elementeve të lëvizshëm gjenetikë
Rosalyn Yalow	1977	Zhvillimi i analizave radioaktive të imunitetit të hormoneve peptide
Gerty Theresa Cori	1947	Zbulimi i rrjedhës së konvertimit katalitik të glikogjenit
Çmimi për Paqe		
1. **Ellen Johnson Sirleaf,** Presidente e Liberisë, gjë që e bën Liberinë vendin e parë afrikan me Presidente femër 2. **Leymah Gbowee,** aktiviste e paqes në kuadër të Lëvizjes së Grave për Paqe në Liberi. Së bashku me Ellen Johnson Sirleaf, ka kontribuar në dhënien fund të luftës civile në Liberi më 2003 3. **Twakkol Karmen,** gazetare, aktiviste e të drejtave të njeriut dhe politikane. Gruaja e parë jemenase dhe arabe që ka fituar Çmimin.	2011	Për luftën jo të dhunshme për sigurinë e grave dhe për të drejtat e grave për pjesëmarrje të plotë
Wangari Muta Maathai, aktiviste politike dhe e mjedisit nga Kenia, ka qenë anëtare e zgjedhur e parlamentit dhe gruaja e parë afrikane që ka fituar Çmimin.	2004	Kontribut në zhvillimin e qëndrueshëm, demokraci dhe paqe
Shirin Ebadi, gjyqtarja e parë femër në Iran para revolucionit. Ajo kishte filluar punë profesionale private në drejtësi për të mbrojtur të drejtat e grave dhe fëmijëve.	2003	Përpjekjet për demokraci dhe të drejtat e njeriut, sidomos lufta e saj për të drejtat e grave dhe të fëmijëve.
Jody Williams, aktiviste politike amerikane, e cila ka punuar në ndalimin dhe pastrimin e minave kundër njerëzve.	1997	Përpjekjet që kanë çuar në ndalimin dhe pastrimin e minave kundër njerëzve
Rigoberta Menchu Tum, është grua indigjene guatemalase e grupit etnik K'iche, e cila i ka kushtuar jetën e saj bërjes publike të gjendjes së vështirë të popullit indigjen të Guatemalës gjatë dhe pas luftës civile	1992	Në shenjë mirënjohjeje të punës së saj për drejtësi sociale dhe pajtim etno-kulturor të bazuar në respektimin e të drejtave të popujve indigjenë
Aung San Suu Kyi, udhëheqëse e opozitës në Burma, e cila ka kaluar pothuajse 21	1991	Për luftën e saj jo të dhunshme për demokraci

vjet në arrest shtëpiak (1989 - 2010)		dhe të drejtat e njeriut
Alva Myrdal, sociologe, politikane dhe diplomate suedeze. Më 1950 ajo ka mbajtur një post të lartë në OKB, gruaja e parë në këtë post. Përkrahëse e zëshme e çarmatimit, gjë që e ka përdorur në diplomaci.	1982	Për përpjekjet e saj për çarmatim dhe zona pa armë bërthamore
Nënë Tereza (Anjezë Gonxhe Bojaxhiu), murgeshë katolike e cila ka udhëhequr shtëpi azilesh dhe strehimore për të sëmurët të varfër në Indi, si dhe punë të ndihmës humanitare në disa vende.	1939	Në shenjë mirënjohjeje për punën e saj humanitare në mbarë botën
Betty Williams ishte me baba protestant dhe nënë katolike. Pas vrasjes në Belfast të tre fëmijëve të pafajshëm kishte themeluar Komunitetin e Njerëzve të Paqes, së bashku me **Mairead Corrigan** (e cili ishte tezja e fëmijëve të vrarë dhe me të cilën ajo ka ndarë Çmimin Nobel). Kjo lëvizje më vonë ishte shpërbërë për shkak të thashethemeve ekstremiste. Megjithatë, Mairead Corrigan ka vazhduar të besojë se një lëvizje e tillë do të mund të kishte ndikim edhe pas shpërbërjes dhe ajo ka vazhduar me përpjekje të tillë në nivelin lokal.	1976	Në shenjë mirënjohjeje për krijimin e një lëvizjeje paqësore në Irlandën e Veriut
Emily Greene Balch, ekonomiste amerikane dhe Profesoreshë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Ajo ka luajtur rol qendror në Lidhjen Ndërkombëtare të Grave për Paqe dhe Liri, dhe në shenjë mirënjohjeje për këtë i është dhënë Çmimi Nobel për Paqe. Më 1917 ajo ka kritikuar SHBA-të për shkak të hyrjes në luftën dhe kishte paralajmëruar kundër fashizmit, duke i kritikuar demokracitë perëndimore për mungesën e përpjekjeve për të ndalur politikat agresive të Hitlerit dhe Musolinit. Në dritën e komenteve të tilla, ajo ishte perceptuar në SHBA si radikale dhe kishte humbur titullin e	1946	Në shenjë mirënjohjeje për punën e saj në lëvizjen paqësore

Profesoreshës.		
Jane Addams, sociologe/punëtore sociale amerikane dhe udhëheqëse e lëvizjeve për të drejtën e grave për të votuar dhe për paqe. Më 1919 kishte formuar Lidhjen Ndërkombëtare të Grave për Paqe dhe Liri. Për shumë vite ka punuar për t'i bindur fuqitë e mëdha për t'u çarmatosur dhe arritur marrëveshje të paqes. Gjatë Luftës së Parë Botërore ajo ka udhëhequr një konference në Hagë, me qëllimin që të bindej Presidenti Woodrow Wilson për të ndërmjetësuar paqen mes vendeve ndërluftuese, por pa ndonjë sukses. Ajo ka kritikuar hyrjen e SHBA-së në luftë, si dhe imponimin e Traktatit të Versajës Gjermanisë, më 1919, pasi që, siç kishte thënë, ai ishte aq poshtërues për Gjermaninë se që do të çonte në një luftë të Gjermanisë për hakmarrje. Në atë kohë ajo konsiderohej radikale dhe me rrezik për sigurinë e SHBA-së, edhe pse në fund të jetës ishte nderuar nga ana e qeverisë amerikane për përpjekjet e saj për paqe.	1931	Në shenjë mirënjohjeje për punën e saj në lëvizjen paqësore
Baronesha Bertha Sophie Felicita von Suttner, autore austriake, e cila ka shkruar njërin ndër librat më me ndikim të shekullit XIX kundër luftës, të titulluar "Die Waffen nieder!" (shq, "Dorëzoni armët!"). Ajo është gruaja e parë që ka fituar Çmimin Nobel për Paqe.	1905	Në shenjë mirënjohjeje për punën e saj në lëvizjen paqësore
Ekonomi		
Elinor Ostrom, ekonomiste politike amerikane, e cila ka ndarë Çmimin Nobel për Ekonomi me Oliver E. Williamsonin. Ajo ka botuar një libër mbi "Governing the Commons" ("Qeverisja e të zakonshmëve") dhe është e vetmja femër deri më sot që ka fituar Çmimin Nobel për Ekonomi.	2009	Për analizën e saj mbi qeverisjen ekonomike, në veçanti për njerëzit e zakonshëm

4 STEREOTIPAT DHE PARAGJYKIMET






Përkufizimet


Orientimi seksual	I referohet kapacitetit të secilit person për tërheqje të thellë emocionale, afektive dhe seksuale ndaj, dhe marrëdhënieve intime dhe seksuale me, individë të një gjinie të ndryshme, të gjinisë së njëjtë, ose të më shumë se një gjinie
Identiteti gjinor	I referohet asaj se si çdo person e ndien gjininë thellë nga brenda dhe e përjeton atë si individ, gjë që mund ose jo të të cilat mund të korrespondojnë ose jo me gjininë e dhënë me lindje, përfshirë atë se si e ndjen personalisht trupin (gjë që mund të përfshijë, nëse personi përkatës zgjedh lirisht, modifikime të dukjes ose funksioneve personale përmes mjeteve mjekësore, kirurgjikale ose të tjera mjete) dhe shprehje të tjera të gjinisë, përfshirë veshjet, të folurit dhe gjestet

Shihni Preambulën e Parimeve të Jogxhakartës, Zbatimi i së Drejtës Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut në raport me Orientimin Seksual dhe Identitetin Gjinor




Përse njerëzit krijojnë stereotipa:

- Ndihmojnë për t'i trajtuar dallimet
- U ndihmojnë njerëzve për të krijuar identitet grupor
- I bën njerëzit të ndjehen të sigurt.



Stereotipat gjinorë në Kosovë:



Stereotipat për djemtë:

- Duhet ta mbajnë familjen;
- Duhet të martohen dhe të sigurohen që të kenë një djalë për të vazhduar linjën e familjes;
- Duhet të trashëgojnë të gjitha pronat dhe të ndërmjetësojnë, nëse është e nevojshme, për motrat e tyre;
- Duhet të sigurohen që gratë e tyre të nderojnë të gjithë anëtarët e familjes;
- Nuk duhet të ndihmojnë me punët në shtëpi, pasi që kjo është punë e grave;
- Duhet të jenë të kujdesshëm që të zgjedhin një karrierë që është e përshtatshme për burra;

Hulumtim nga Qendra Kosovare për Studime Gjinore, më 2013	PO	JO	MESHKUJ – PO	FEMRA PO
Vajzat pritet të kenë marrëdhënie seksuale me të dashurit e tyre nëse ata shpenzojnë shumë të holla kur të dalin së bashku	24%	76%	33%	15%
Kur femrat thonë JO, ato nënkuptojnë PO	45%	55%	55%	35%
Mashkulli i vërtetë është aktiv, agresiv, i pacarur dhe dominues	40%	60%	47%	34%
Vajza pritet të jetë e virgjër kur fillon një lidhje	65%	35%	59%	70%
Xhelozia është mënyrë për të treguar dashuri	49%	51%	51%	47%
Një person që abuzon njerëz të tjerë nën ndikimin e alkoolit ose drogës nuk është i/e përgjegjshëm/me për sjelljet e tij/saj	44%	56%	43%	44%
Është e pranueshme që i dashuri ta qëllojë të dashurën e tij nëse ajo e ka tradhtuar	44%	56%	46%	40%
Fëmijët kanë nevojë për të atin e tyre edhe kur ai është i dhunshëm ndaj tyre së ëmës së tyre	44%	56%	51%	38%
Pasojat psikologjike/emocionale të abuzimit janë po aq serioze sa pasojat e keqtrajtimit fizik	71%	29%	65%	75%
Përdhunimi mund të ndodhë në martesë	54%	46%	56%	53%
Një lidhje e suksesshme është e mundur edhe kur vajza nuk është e virgjër	69%	31%	64%	72%
Është e zakonshme që të lësh pas dore miqtë/miket kur ke të dashur	34%	66%	30%	37%
Gruaja duhet të ketë kujdes që të mos e provokojë/kundërshtojë burin e saj	66%	34%	64%	68%
Është e lehtë ta braktisësh partnerin/-en kur të kesh vendosur ta ndërpresësh një lidhje të dhunshme	49%	51%	52%	46%
Njerëzit i abuzojnë dhe keqtrajtojnë partnerët e tyre në përpjekje për të ushtruar kontroll mbi ta	60%	40%	60%	60%
Vetëm femrat janë përgjegjëse për përkujdesje ndaj fëmijëve dhe për punët e shtëpisë	40%	60%	43%	37%
Gruaja e përsosur është pasive, e dashur, e brishtë dhe llafazane	33%	67%	33%	33%

Efektet e stereotipave dhe paragjykimeve

Stereotipat dhe paragjykimet mund të kenë ndikim të thellë te individi si dhe në shoqërinë në tërësi. Në këtë aspekt, Kosova nuk përbën përjashtim kur kemi të bëmë me stereotipat që ekzistojnë në lidhje me meshkujt dhe femrat dhe rolin që ata duhet të luajnë në shoqëri, si dhe në lidhje me pjesëtarët e komunitetit LGBT.

Së pari dhe më kryesorja, stereotipat dhe paragjykimet do të ndikojnë ***shëndeti emocional dhe mendor*** të individit, pasi që individët në jetën e tyre përballen çdo ditë me komente stereotipike ose paragjykime.


Shembuj:

1. Një gruaje shumë të suksesshme i thuhet se ajo nuk duhet të marrë mundimin të konkurrojë për ngritje në detyrë, pasi që gratë nuk janë të afta për menaxhim.
2. Një mashkulli të ri të talentuar, i cili dëshiron të bëjë balet, i thuhet nga i ati i tij se nuk duhet të marrë mundimin të ndjekë këtë dëshirë, pasi që kjo nuk është punë e vërtetë.

Përkundrazi, ai duhet të punojë në fushë, të mbjellë perime, gjë që është shumë më produktive, të martohet dhe të fillojë një familje.

Në të dy skenarët, efekti i menjëhershëm është se stereotipat që ekzistojnë kanë ndikim të thellë në vetëbesimin dje vetë-respektin e këtyre individëve, si dhe ndikim negativ në karrierën e tyre. Në të njëjtën kohë, stereotipat kanë gjithashtu ndikim në shoqëri në tërësi. Kjo ndodh për shkakun se moslejimi i një gruaje që të konkurrojnë për pozita kyçe është dicka shumë kundër-produktive, pasi që kompania në fjalë nuk përfiton nga njohuritë që ajo mund të sjellë. Ngjashëm, kultura dhe artet do të humbnin një interpretues të talentuar i cili ndoshta do të mund të japë kontribut të madh. Përveç kësaj, në të dy skenarët do të ketë mundësi të kufizuara për të sfiduar vetë këto stereotipa, pasi që do të ketë më pak modele rolesh për fushat përkatëse.

Si të trajtohen stereotipat dhe paragjykimet



Shembull: Klubi 'Bëhu burrë'

Kjo është iniciativë e zhvilluar nga ana e Care International në Kosovë, i cila ka për synim parandalimin e dhunës dhe sjelljes diskriminuese ndaj grave dhe vajzave përmes punës së bashku me djem. Nëpërmjet aktiviteteve të ndryshme, të rinjtë mund të reflektojnë mbi qëndrimet e tyre dhe rolet sociale, si dhe të marrin pjesë në punëtori për të diskutuar mbi rolet gjinore, dhunën dhe seksin, tema të cilat ata mund të mos i kenë diskutuar më herët.

Të flasësh për ndjenjat

Gramosi thotë se ai ka ndryshuar shumë – "Tani jam në gjendje të flas për ndjenjat e mia pa ndjerë turp. Me të vërtetë kam evoluar dhe mendoj më tepër rreth asaj se si i trajtoj njerëzit e tjerë dhe çfarë është e rëndësishme në jetën time". Atij i është dukur kjo përvojë shumë pozitive sa që thotë se dëshiron t'i inkurajojë të gjithë që t'i bashkohen kësaj iniciative.

Më tepër informata mund të gjeni këtu: http://www.careinternational.org.uk/what-we-do/war-conflict-and-peacebuilding/conflict-related-sexual-violence/news-kosovo-men-learn-news-ways-to-be-a-man.

Informata lidhur me klube të ngjashme në rajon mund të gjeni këtu: http://www.yeu-international.org/en/publications/newsmail/small-stories-that-can-change-the-world/be-a-man-club-stop-violence-against-girls-and-women

5 DHUNA ME BAZË GJINORE



FAKTI 1: *'Numri i rasteve të raportuara të dhunës në familje në Kosovë është mbi 1,000 brenda një viti'*[45]

FAKTI 2: *'Nga janari deri në gusht 2013, në Kosovë janë identifikuar 48 viktima të trafikimit me qenie njerëzore. 44 prej tyre kanë qenë femra dhe 4 meshkuj'*[46].

FAKT 3: *'11% e vajzave adoleshente në Kosovë të cilat janë në lidhje romantike pranojnë se janë goditur ose qëlluar me shuplakë nga partnerët e tyre meshkuj'*[47].

FAKTI 4: *46% e grave që jetojnë në Kosovë kanë përmendur prova të dhunës në familje në lagjen e tyre, dhe 12% kanë qenë dëshmitare të rrahjes së një gruaje nga bashkëshorti i saj. Megjithatë, më shumë se gjysma e grave që e kanë pësuar nuk kanë raportuar në polici*[48].

Hyrje

Karakteristika kryesore e dhunës me bazë gjinore është se ndodh ndaj grave pikërisht për shkak të gjinisë. Dhuna më bazë gjinore përmban në vete pabarazi të fuqisë, ku më së shpeshti meshkujt janë kryerës dhe femrat viktima. Zakonisht femrat që u përkasin minoriteteve janë edhe më të cenueshme, pasi që përballen me margjinalizim të dyfishtë. Në këtë kapitull shqyrtojmë hollësisht shkaqet dhe faktorët që kontribuojnë në dhunën me bazë gjinore, efektet e ndryshme të dhunës me bazë gjinore për viktimat dhe familjet e tyre, kryerësit dhe shoqërinë në tërësi, si dhe një shumëllojshmëri të përgjigjeve të mundshme të shoqërisë ndaj këtij fenomeni.

[45] Qendra Kosovare për Studime Gjinore (QKSGj), 'Prania e dhunës në marrëdhëniet e adoleshentëve', 2012, në dispozicion në http://www.unfpakos.org/wp-content/uploads/2012/12/Prevalence-of-violence-alb-finale-DRINI.pdf, qasur më 11/05/2014

[46] Poaty

[47] Poaty

[48] Qendra Evropiane për Çështje të Minoriteteve në Kosovë, Buletin informativ: Rasti i Diana Kastratit: dhuna në familje dhe drejtësia kosovare, dhjetor 2013, Në dispozicion në https://ecmikosova.org/the-diana-kastrati-case-violence-against-women-and-kosovar-justice/
(vetëm në anglisht), qasur më 10/05/2014

Përkufizime[49]

- **Dhuna me bazë gjinore:** çfarëdo veprimi që rezulton, ose ka të ngjarë të rezultojë, në dëmtim fizik, seksual, psikologjik ose ekonomik, ose vuajtje bazuar në gjininë e një personi. Kjo zakonisht i referohet dhunës së kryer ndaj grave dhe vajzave, por mund të kryhet edhe ndaj burrave dhe djemve, dhe gjithashtu përfshin dhunën kundër personave lezbike, gay, biseksualë dhe transseksualë.

- **Dhuna në familje**[50]

  Nuk ka përkufizim universal të dhunës në familje. Në Kosovë, ajo përkufizohet si çfarëdo akt apo mosveprim i qëllimshëm që rezulton në abuzim, kur kryhet nga një person i cili është ose ka qenë në lidhje familjare me viktimën, në forma të tilla si dhunë fizike, dhunë psikologjike, abuzim seksual dhe abuzim ekonomik.

Dhuna në familje përbën, mbi të gjitha, një shqetësim në aspektin e të drejtave të njeriut. Ajo i ka rrënjët thellë në marrëdhëniet e pabarabarta të fuqisë. Autoritetet janë të obliguara të parandalojnë dhunën në familje, të mbrojnë viktimat dhe t'i ndjekin penalisht kryerësit.

Megjithatë, shteti ka dështuar të parandalojë rastet e dhunës në familje. Kjo ka ndodhur me Diana Kastratin, e cila ishte vrarë tragjikisht nga ish-bashkëshorti i saj, siç pretendohet, pasi Gjykata Komunale e Prishtinës kishte dështuar të nxirrte urdhrin për mbrojtje në kohën e duhur. Familja e saj i kishte dorëzuar një rast Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykata kishte vendosur se e drejta e Dianës në jetë dhe e drejta për mjete juridike ishin shkelur[51].

- **Çka është urdhri për mbrojtje?**

Urdhri për mbrojtje është urdhri i lëshuar nga një gjykatë që parasheh masa mbrojtëse të një viktime të dhunës në familje nga kryerësi. Gjykata Komunale shqyrton kërkesën për urdhër për mbrojtje dhe vendosë brenda 15 ditëve pas pranimit të kërkesës, përveç nëse kërkesa është Urdhër për Mbrojtje Emergjente, për të cilin Gjykata duhet të vendosë brenda 24 orëve.

- **Çka është viktima e dhunës në familje?**

Viktimë e dhunës në familje është një person i cili pëson nga një akt i dhunës në familje. Përkundër faktit se gratë janë më shpesh viktima të dhunës në familje, burrat, fëmijët, të

[49] At all, 'Ngrite zërin kundër dhunës ndaj grave – 16 ditë aktivizëm 2013', Prishtinë, 2013, në dispozicion në http://kreatoda.com/upload/E-Libri_Albanian.pdf, qasur më 11/05/2014

[50] OSBE – Misioni në Kosovë, 'Katalog për këshilla dhe ndihmë për viktimat e dhunës në familje', në dispozicion në http://www.osce.org/sq/kosovo/88709?download=true, qasur më 12/05/2014

[51] Për më tepër informata rreth rastit, shihni Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese *Gëzim dhe Makfire Kastrati kundër Gjykatës Komunale në Prishtinë dhe Këshillit Gjyqësor të Kosovës*, rasti nr. KI 41/12, në dispozicion në http://www.gjk-ks.org/repository/docs/gjkk_ki_41_12_shq.pdf

moshuarit dhe personat me aftësi të kufizuara gjithashtu mund të jenë viktima të dhunës në familje. Dhuna në familje mund ta prekë secilin, pavarësish gjinisë, moshës, fesë, identitetit gjinor, orientimit seksual, grupit etnik, përkatësisë politike apo çfarëdo statusi tjetër.

- **Kush është kryerës i dhunës në familje?**

Kryerës i dhunës në familje është personi i cili kryen një akt të dhunës në familje. Kryerës nuk janë vetëm meshkujt, femrat gjithashtu mund të konsiderohen kryerëse nëse kryejnë një akt të dhunës në familje. Viktimat dhe kryerësit e dhunës në familje janë të lidhur nëpërmjet marrëdhënieve në familje.

- **Çka është marrëdhënia në familje?**

Kryerës i dhunës në familje është personi i cili kryen një akt të dhunës në familje. Kryerës nuk janë vetëm meshkujt, femrat gjithashtu mund të konsiderohen kryerëse

Marrëdhënia në familje ekziston kur viktima dhe kryerësi:

- Janë ose kanë qenë të fejuar, martuar, në bashkim familjar jashtëmartesor apo bashkëjetojnë në një ekonomi familjare të përbashkët;
- Janë prindër të një fëmije të përbashkët;
- Shfrytëzojnë një shtëpi të përbashkët dhe kanë lidhje gjaku, martese, në formë të adoptimit ose kujdestarisë (përfshirë prindërit, gjyshërit, fëmijët, nipërit e mbesat, vëllezërit e motrat, hallat e tezet, xhaxhallarët e dajallarët, ose kushërinjtë);
- Palë procedurale në një kontest që përfshin një marrëdhënie familjare.

- **<u>Dhuna ndaj grave:</u>** çfarëdo akt dhune me bazë gjinore që rezulton ose ka të ngjarë të rezultojë në dëmtime ose vuajtje fizike, seksuale ose mendore të grave, përfshirë kërcënime për akte të tilla, presionet, kërcënime ose privim arbitrar të lirisë, që ndodhura qoftë publikisht ose në jetën private. Dhuna në familje: sjellje të njëjta të përsëritura në formë presioni e kërcënimi, qoftë fizik, psikologjik ose seksual, kundër cilitdo anëtari të familjes apo ekonomisë familjare, përfshirë nga ana e një partneri/-eje intim/-e. Dhuna në familje ndaj grave dhe vajzave sillet nga poshtërimi dhe presionet e kërcënimet ekonomike e deri te sulmet fizike, zakonisht që kryhen nga ana e partnerëve intimë, bashkëshortëve, vëllezërve, xhaxhallarëve, dajallarëve ose meshkujve brenda ose që kanë lidhje familjare me personat e shtëpisë në fjalë. Dhuna brenda një gjinie, për shembull, kryhet nga një anëtare e familjes kundër një anëtareje tjetër të familjes, kur vjehrrat rrahin nuset e reja ose anasjelltas. Megjithatë, dhuna e meshkujve ndaj femrave ndodh shumë më shpesh.

- **<u>Dhuna seksuale:</u>** çfarëdo akti seksual, përpjekje për të kryer një akt seksual, komente ose afrim të padëshiruar seksuale, akte trafikimi ose të tjera të drejtuara kundër seksualitetit të një personi përmes shfrytëzimit të presioneve e kërcënimeve, nga cilido person, pavarësisht nga marrëdhëniet e tyre me viktimën dhe në çfarëdo mjedisi.

- **<u>Çfarë janë strehimoret dhe cfarë u ofrojnë ato viktimave të dhunës në familje[52]?</u>**

  Strehimorja është vend i sigurt ku viktimat e dhunës në familje dhe fëmijët e tyre mund të qëndrojnë përkohësisht dhe në të cilën atyre u ofrohet mbrojtje dhe shërbime të tjera. Aktualisht ka strehimore në Gjakovë, Gjilan, Mitrovicë, Pejës, Prishtinë dhe Prizren, ku strehohen viktimat nga komunitetet në të gjithë Kosovën. Viktimat mund të qëndrojnë në strehimore për gjashtë muaj. Periudha e qëndrimit të tyre mund të zgjatet duke u dakorduar me Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale.

  Strehimoret zakonisht u ofrojnë viktimave strehim, ushqim, veshmbathje, këshilla (këshilla psiko-sociale dhe ligjore), mbështetje mjekësore, trajnime profesionale (për gjuhë, kompjuter, internet, shkrim-lexim, qepje, gatim, shërbime flokësh, rrobaqepësi), edukim shëndetësor, shërbime të kërkimit të vendeve të punës dhe aktivitete për fëmijë (muzikë, vizatim, vallëzim), në mesin e shërbimeve të tjera. Strehimoret patrullohen nga policia dhe kanë forma të tjera të rregullimit të sigurisë së tyre.

- **<u>Ku ndodh dhuna me bazë gjinore?</u>**

  DhBGj mund të ndodhë në shtëpi, lidhje, lagje, komunitet, institucione, vendin e punës ose në rrjetet sociale.

<u>Dhuna ndaj femrave përgjatë ciklit të jetës</u>[53]

Fazat	*Lloji i dhunës*
Para lindjes	Aborti për arsye të zgjedhjes së gjinisë; efektet e rrahjes gjatë shtatzënisë për shkak të rezultatit të lindjes.
Foshnjëria	Vrasja e foshnjave vajza (krimi i vrasjes së fëmijës brenda një viti pas lindjes); abuzimi fizik, seksual dhe psikologjik.
Fëmijëria	Martesa e fëmijëve; gjymtimi gjenital i femrave; abuzimi fizik, seksual dhe psikologjik; incesti; prostitucioni dhe pornografia
Adoleshenca dhe mosha e rritur	Dhuna gjatë periudhës së takimeve romantike dhe atyre para martesës (p.sh. spërkatja me acid dhe përdhunimi gjatë takimeve romantike); marrëdhëniet seksuale përmes presioneve e kërcënimeve ekonomike (p.sh. marrëdhëniet seksuale të nxënëseve me meshkuj të pasur më të moshuar të cilët u japin atyre dhurata ekstravagante ose ua mbulojnë pagesat e shkollimit në këmbim të shoqërimit ose favoreve seksuale); incesti; abuzimi seksual në vendin e punës; përdhunimi; ngacmimi seksual; prostitucioni dhe pornografia e detyruar; trafikimi i femrave; vrasja e partneres; përdhunimi brenda martesës; 'abuzimi dhe vrasja e pajës'; abuzimi psikologjik; abuzimi i grave me aftësi të kufizuara; shtatzënia e detyruar

[52] OSBE – Misioni në Kosovë, 'Katalog për këshilla dhe ndihmë për viktimat e dhunës në familje', në dispozicion në http://www.osce.org/sq/kosovo/88709?download=true, qasur më 11/05/2014

[53] Organizata Botërore e Shëndetësisë, Violence against Women Pack (shq. Paketa rreth dhunës ndaj grave), 1997

Pleqëria (dhuna e imponuar)	Shtatzënia e detyruar, "vetëvrasja" ose vrasja e vejushave për arsye ekonomike; abuzimi seksual, fizik dhe psikologjik për tarifa shkollore); incesti; abuzimi seksual në vendin e punës; përdhunimi; ngacmimi seksual; prostitucioni dhe pornografia e detyruar; trafikimi i femrave; dhuna ndaj partneres; përdhunimi brenda martesës; 'abuzimi dhe vrasja e pajës'; vrasja e partneres; abuzimi psikologjik; abuzimi i grave me aftësi të kufizuara;

Çfarë e shkakton dhunën ndaj grave?

Para ushtrimit, përgatisni një fletë të bardhë tabele ku listoni faktorët që asociohen me dhunën me bazë gjinore. Kërkojuni pjesëmarrësve që t'i referohen kësaj tabele.

Në nivel të shoqërisë:



- Normat që u japin meshkujve kontroll mbi sjelljen e femrave;
- Pranimi i dhunës si mënyrë për zgjidhjen e konflikteve;
- Ndërlidhja e nocionit të të qenit mashkull me dominimin, nderin dhe agresivitetin;
- Rolet e ngurta gjinore.

Në nivel të komunitetit:

- Varfëria, statusi i ulët socio-ekonomik, papunësia;
- Shoqërimi me bashkëmoshatarë të cilët e pranojnë dhe lejojnë dhunën.

Në nivel të familjes dhe lidhjes:

- Izolimi e femrave dhe familjes;
- Konfliktet brenda martesës;
- Kontrolli nga ana e mashkullit i pasurisë dhe vendimmarrjes në familje.

Në nivel të individit:

- Të qenit dëshmitar i dhunës brenda martesës gjatë periudhës së fëmijërisë;
- Mungesa dhe refuzimi nga ana e babait;
- Të qenit i abuzuar si fëmijë;
- Përdorimi i alkoolit.


Sa i përket nivelit të shoqërisë, studimet në mbarë botën kanë zbuluar se dhuna ndaj grave është më e zakonshmja aty ku rolet gjinore janë të përkufizuar dhe imponohen në mënyrë të prerë, dhe ku koncepti i maskulinitetit (të qenit mashkull) lidhet me qëndrueshmëri e ashpërsi, nderin mashkullor,

ose me dominim. Norma të tjera kulturore që lidhen me abuzimin përfshijnë tolerancën ndaj ndëshkimit fizik të grave dhe fëmijëve, pranimin e dhunës si mjet për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndër-personale, dhe perceptimin se burrat kanë "pronësi" ndaj femrave.

Në nivel të komunitetit, izolimi i femrave dhe mungesa e mbështetjes nga shoqëria, së bashku me grupet e bashkëmoshatarëve meshkuj që e pranojnë, lejojnë dhe legjitimojnë dhunën e meshkujve, na bëjnë të parashikojmë norma më të larta të dhunës.

Në nivel të familjes dhe lidhjes, në studime ndër-kulturore është përmendur kontrolli nga ana e meshkujve i pasurisë dhe vendimmarrjes brenda familjes dhe konfliktet brenda martesës si elemente të forta përcaktuese të abuzimit.

Në nivel të individit, këto përfshijnë të qenit i abuzuar si fëmijë apo të qenit dëshmitar i dhunës brenda martesës në shtëpi, të pasurit një baba që mungon ose refuzues, dhe përdorimin e shpeshtë të alkoolit.



Ndikimi i dhunës në baza gjinore në shëndetin e grave:

Dhuna me bazë gjinore ndërlidhet me shumë probleme të rënda shëndetësore, të menjëhershme dhe afatgjata. Këto përfshijnë probleme shëndetësore fizike dhe psikologjike:

- *Fizike*
  - lëndimet,
  - aftësitë e kufizuara,
  - problemet shëndetësore kronike (sindromi i zorrëve të irrituara, çrregullime të lukthit dhe zorrëve, sindrome të ndryshme të dhimbjeve kronike, hipertensioni, etj.),
  - problemet shëndetësore seksuale dhe ato të riprodhimit (marrja e sëmundjeve seksualisht të transmetueshme, përhapja e HIV/AIDS, shtatzënitë me rrezik të lartë, etj.),
  - vdekja.
- Efektet *psikologjike* mund të jenë të drejtpërdrejta dhe të tërthorta
  - Të drejtpërdrejta: ankthi, frika, mosbesimi ndaj të tjerëve, pamundësia për t'u përqendruar, vetmia, çrregullimet e stresit post-traumatik, depresioni, vetëvrasja, etj.
  - Të tërthorta: sëmundjet psikosomatike (sëmundje që prekin mendjen dhe trupin në të njëjtën kohë), mbyllja në vetvete, përdorimi i alkoolit ose drogës.

Ndikimi ekonomik dhe social:

- Refuzimi, izolimi dhe stigmatizimi social në nivel të komunitetit;
- Reduktimi i aftësinë për të marrë pjesë në aktivitete shoqërore dhe ekonomike;
- Frika akute nga dhuna në të ardhmen, e cila e tejkalon personin që ka pësuar dhunë, duke prekur pjesëtarët e tjerë në komunitet;
- Dëmtimi i vetëbesimit të grave, gjë që rezulton në frikën nga dalja në hapësira publike (kjo shpesh mund të zvogëlojë arsimimin e grave, gjë që, nga ana vet, mund të kufizojë mundësitë e tyre për gjenerimin e të ardhurave);
- Rritja e cenueshmërisë ndaj llojeve të tjera të dhunës me bazë gjinore;
- Humbja e vendeve të punës, për shkak të mungesave, si pasojë e dhunës;
- Ndikimi negativ në kapacitetin e grave për të gjeneruar të ardhura.

Ndikimit në familjet e grave dhe personat që varen prej tyre:

- **Efektet e drejtpërdrejta:**
  - divorci, ose shpërbërja e familjeve;
  - rrezikimi i zhvillimit ekonomik dhe emocional të familjes;
  - lindja e fëmijëve me çrregullime shëndetësore, si pasojë e dhunës së përjetuar nga nëna gjatë shtatzënisë (d.m.th. lindja e parakohshme ose peshë e ulët në momentin e lindjes);
  - shtimi i gjasave të dhunës kundër fëmijëve që rriten në familje ku ka dhunë në familje;

- efekte anësore mbi fëmijët që janë dëshmitarë të dhunës në shtëpi (çrregullime emocionale dhe të sjelljes, për shembull, mbyllja në vete, shkallë e ulët vetëvlerësimi, ankthe, vetë-fajësim, agresivitet ndaj bashkëmoshatarëve, anëtarëve të familjes dhe gjërave në posedim; shtim të rrezikut që si të rritur të bëhen kryerës ose viktima të dhunës).

- **Efektet e tërthorta:**
  - Kompromet imi i aftësisë së personit që ka pësuar dhunë për t'u kujdesur për fëmijët e saj (p.sh. kequshqyerja dhe lënia pas dore e fëmijëve, për shkak të efektit kufizues të dhunës në strategjitë e jetesës së grave dhe pozitës së tyre në kuadër të marrëdhënieve në martesë);
  - Qëndrime ambivalent ose negative të një personi që ka pësuar përdhunim ndaj fëmijës së dalë nga marrëdhënia në fjalë.

Ndikimi i dhunës te kryerësit:

- sanksionimi nga ana e komunitetit, përballja me arrestim dhe burgim;
- kufizimet ligjore për të vizituar familjen, divorci, ose ndarja nga familjet e tyre;
- ndjenja e tjetërsimit nga familjet e tyre;
- minimizimi i rëndësisë së dhunës për të cilën janë përgjegjës; hedhja e përgjegjësisë për dhunën e shkaktuar partnereve të tyre dhe pamundësia për ta asocuar atë me lidhjen e tyre;
- tensione të shtuara në shtëpi.

Ndikimi i dhunës te shoqëria:

- barrë për sistemin shëndetësor dhe atë të drejtësisë;
- pengesë për stabilitetin ekonomik dhe rritjen ekonomike, për shkak të humbjes së produktivitetit të grave;
- humbja e besimit në marrëdhëniet shoqërore;
- dobësimi i rrjeteve mbështetëse nga të cilët varen strategjitë e njerëzve për mbijetesë.

<u>Përgjigjet sociale ndaj dhunës gjinore bien në kuadër të disa kategorive:</u>

Kërkojuni pjesëmarrësve që t'i referohen fletës në tabelë, të përgatitur para të ushtrimit, e cila liston përgjigjet sociale në vijim:

<u>Përgjigjet sociale nda dhunës me bazë gjinore:</u>

- shërbimet e kujdesit shëndetësor;
- shërbimet e ndihmës viktimave;
- puna me kryerësit;
- shqyrtimi i maskulinitetit (të qenit mashkull);
- fushata të informimit përmes mediave dhe të vetëdijesimit;
- arsimimi;
- përgjigjet ligjore.

Indeksi 5: Përgjigjet sociale ndaj dhunës me bazë gjinore[54]:

- **Kujdesi shëndetësor –** trajtimi i ofruesve të shërbimeve të kujdesit shëndetësor që të njohin dhe t'i përgjigjen dhunës me bazë gjinore është një nga mënyrat më të rëndësishme për identifikimin dhe ofrimin e ndihmës viktimave. Jo vetëm obstetrit/gjinekologët, por të gjithë profesionistët e kujdesit shëndetësor duhet të mësojnë të njohin shenjat: spitalet (në veçanti stafi i reparteve të emergjencës); stafi i klinikave shëndetësore publike dhe private; profesionistët/mjekët e përgjithshëm/të mjekësisë familjare; mjekët internë; pediatrit; psikiatrit; infermieret dhe stafi i klinikave të planifikimit familjar.

- **Shërbimet për ndihmë viktimave –** këto janë shërbime të krijuara ose të inkorporuara, me qëllimin për t'iu përgjigjur dhunës me bazë gjinore, shërbime të cilat janë si në vijim: strehimore për gra të goditura nga dhuna fizike; strehimore për të pastrehë; programe për ndihmë financiare; stacione ose shërbime të policisë për gra; programe për mbrojtjen e viktimave; linja të drejtpërdrejta telefonike kundër krizave të përdhunimit, dhunës në familje dhe për parandalimin e vetëvrasjes; shërbime juridike; programe mobile; programe të mirëqenies sociale; shërbime për përkrahje psikologjike (përfshirë grupe për këshillim dhe mbështetje individuale) dhe programe/shërbime të shëndetit seksual të adoleshentëve.

- **Grupet përkrahëse –** ndonëse grupet përkrahëse mund të bien në kuadër të shërbimeve të asistencës viktimave, ato meritojnë vëmendje të veçantë për shkak se jo në të gjitha rastet janë shërbime të organizuar jashtë tyre. Grupet për përkrahje mund të jenë një mënyrë e rëndësishme për vetë viktimat për t'u organizuar në mënyrë proaktive dhe marrë përgjegjësinë për gjendjen e tyre. Përtej përkrahjes emocionale, anëtarët e këtyre grupeve gjithashtu mund t'i ofrojnë njëri-tjetrit një ndjenjë sigurie, e madje edhe një vend për të qëndruar, nëse është e nevojshme.

- **Puna me kryerësit** – puna me kryerësit/ushtruesit e dhunës (programet e inverventimit ndaj ushtruesve të dhunës) është përgjigje e kundërthënëse dhe herë pas here e suksesshme. Ndërsa shërbimet e ndihmës viktimave përbëjnë një pjesë dobishme, por të pjesshme dhe të atypëratyshme, për të trajtuar një problem ekzistues, kjo qasje ka si pikësynim përpjekjet në burim të problemit, pasi që është përpjekje për të ndryshuar sjelljen e dhunshme të meshkujve.

- **Shqyrtimi i maskulinitetit (të qenit mashkull)** – Programet të cilat adresojnë maskulinitetin përpiqen të gjurmojnë atë se cfarë "e përbën një mashkull" Ideja qendrore e kësaj është edukimi i djemve që nga mosha e hershme se dhuna (ndaj kujtdo) është e gabuar, se përkufizimi mbizotërues i maskulinitetit në një shoqëri nuk është e vetmja alternativë, dhe se edhe pse janë fizikisht të ndryshme, vajzat kanë të drejtë të gëzojnë të njëjtat të drejta dhe mundësi si meshkujt.


[54] Organizata Shëndetësore Pan-amerikane, Fact sheet, Women, Health and Development (Broshurë të dhënash: gratë, shëndeti dhe zhvillimi), në dispozicion në http://www1.paho.org/English/HDP/HDW/socialresponsesgbv.pdf, qasur më 12/05.2014

- **Informimi përmes mediave dhe fushatat e vetëdijesimit** – mediat përbejnë një kanal të rëndësishëm për ta bërë DhBGj të dukshme, për t'u dhënë publicitet zgjidhjeve, pastaj për t'i informuar hartuesit e politikave dhe për të edukuar publikun mbi të drejtat e parapara me ligj dhe atë si duhet identifikuar dhe adresuar DhBGj-në. Gazetat, revistat, buletinet informative, radioja, televizioni, industria e muzikës, filmi, teatri, reklamat, interneti, afishet, fletëpalosjet, tabelat informuese në komunitet, bibliotekat dhe posta direkte, që të gjitha janë kanale për ofrimin e informatave viktimave dhe publikut të gjerë në lidhje me parandalimin e DhBGj-së dhe shërbimet në dispozicion.

- **Arsimimi** – sistemet e shkollave janë të dobishëm për të ndalur DhBGj-në para se të paraqitet. Plan-programet e rregullta, edukimi seksual, programet e këshillimit nëpër shkolla dhe shërbimet shëndetësore në to, të gjitha këto mund shërbejnë për të përcjellë mesazhin se dhuna është e gabuar dhe mund të parandalohet, për të sugjeruar modele alternative të maskulinitetit, për t'u mësuar nxënësve shkathtësi për zgjidhjen e konflikteve dhe për t'u ofruar ndihmë fëmijëve/adoleshentëve që mund të jenë viktima ose ushtrues të dhunës. Integrimi i DhBGj-së si temë në kuadër të psikologjisë, sociologjisë, mjekësisë, infermierisë, së drejtës, studimeve mbi gratë, punës sociale dhe programeve të tjera u mundëson atyre që ofrojnë këto shërbime që të identifikojnë dhe të kujdesen për të adresuar këtë problem.

- **Përgjigjet ligjore** – kriminalizimi (shpallja vepër kriminale) e të gjitha formave të DhBGj-së – dhunës në familje, përdhunimit, ngacmimit seksual, dhunës psikologjike etj., – ka qenë një hap i rëndësishëm në eliminimin e saj. Ajo çfarë mbetet është zbatimi i vazhdueshëm i këtyre ligjeve, ekzekutimi i dënimeve, dhe një fokus më të madh në rehabilitimin e kryerësve të dënuar. Përgjigje të tjera ligjore ndaj DhBGj-së kanë përfshirë shërbime të ndihmës juridike; trajnimin e policisë dhe personelit gjyqësor; stacionet policore me femra; avokimin dhe lotimin për ligje; trajnimin e juristëve të gjykatave të cilët merren me të drejtën e familjes, atë penalë, të emigracionit dhe atë për të mitur, si dhe avokimi nga shoqatat e avokatëve.

6 DREJTËSIA



"Padrejtësia diku është kërcënim për dretjësinë kudo"

Martin Luther King

Cka nënkupton drejtëisa – qasjen në drejtësi?

Përkufizimi i "drejtësisë"

1) drejtësia si trajtim i barabartë

2) drejtësi morale

3) një skemë ose sistem i së drejtës në të cilën çdo person, qoftë fizik apo juridik, merr pjesën e e tij/saj nga sistemi, përfshirë të gjitha të drejtat.

Dini të drejtat tuaja!

Nëse keni qenë viktimë e shkeljes së të drejtave civile, një nga pyetjet që duhet të bëni është: A është shkelur njëra nga të drejtat tuaja të mbrojtura? Në mënyrë që të mund t'i përgjigjeni pyetjes tuaj, ju duhet të jeni në gjendje të dini të drejtat tuaja. Prandaj, të dini të drejtat tuaja përbën një element thelbësor në mënyrë që t'i gëzoni ato dhe të siguroheni që ato të mos shkelen.

Kërkoni të drejtat tuaja!

Nëse përgjigjja juaj është po, hapi tjetër i juaji është t'i dorëzoni një ankesë autoritetit përkatës publik që është përgjegjës për shkeljen në fjalë. Nëse ankesa juaj nuk trajtohet si duhet dhe mendoni se nuk jeni kompensuar si duhet ose shkelja vazhdon, mund të dorëzoni një rast në gjykatat e rregullta. Viktima çdoherë duhet të ketë parasysh që të konsultohet me një avokat, sepse raste të shkeljes së të drejtave civile janë në të gjitha rastet të ndërlikuara dhe nevojiten këshilla profesionale.

Hyrje[55]

Cilët mekanizma sigurojnë drejtësinë në Kosovë?

Në kapitujt e mëparshëm janë prezantuar një varg të të drejtash të njeriut, të cilat janë të parapara me shumë dokumente juridike ndërkombëtare dhe ligje kombëtare të zbatueshme në Kosovë. Megjithatë, dokumentet ligjore mund të zbatohet dhe të drejtat të mbrohen vetëm përmes mekanizmave, dhe për këtë arsye mekanizmat jo-gjyqësorë dhe gjyqësorë janë veçanërisht të rëndësishëm. Prandaj, është shumë e rëndësishme që të kuptohen termat në vijim.


Kërkojuni nxënësve që të punojnë në grupe për të identifikuar se çfarë nënkuptojnë termat në vijim. Pastaj kërkoni një përfaqësuesi të secilit grup që të prezantojë para klasës mbi përkufizimet, dhe pas kësaj shpjegoni përkufizimet dhe termat e saktë të cilat mund t'i gjeni pas pyetjeve në vijim.

Pyetjet e ndërlidhura me përkufizimet:

- **Çfarë është roli i gjykatës?**

  Roli i gjykatës është të zgjidhë mosmarrëveshjet ligjore ndërmjet:

  - Shtetit dhe individëve ose
  - ndërmjet individëve përmes
  - sistemit të drejtësisë penale ose
  - sistemit të drejtësisë civile, përfshirë asaj administrative në raport me mosmarrëveshjet me qeverinë.



- **Çfarë është roli i gjyqtarit?**

  - Çdo gjykatë ka gjyqtarë. Gjyqtarët shqyrtojnë provat e të gjitha palëve të një rasti, dhe interpretojnë ligjin dhe atë se si ajo zbatohet bazuar në provat e paraqitura. Provat zakonisht paraqiten nga avokatët në emër të klientëve të tyre, të cilët e kanë dorëzuar rastin në gjykatë ose janë paditur në gjyq.

  - Pasi gjyqtari të ketë shqyrtuar të gjitha provat, ai/ajo nxjerr një gjykim ose merr një vendim. Ai/ajo mund, për shembull, të çojë një kriminel në burg, apo të thotë se dikush duhet t'i paguajë dikujt tjetër për trajtimin e tyre në mënyrë të padrejtë.



[55] EDC/HRE, Council of Europe Publishing, në dispozicion në http://tandis.odihr.pl/documents/hre-compendium/en/CD%20SEC%203/PARTNERS'%20RESOURCES/CoE%20Teaching%20democracy%20ENG.pdf, qasur më 07/05/2014

- **Cilat janë arsyet për të cilat mund të shkoni në gjykatë?**
  - Jeni paditës, pasi që keni ngritur një padi civile;
  - Jeni i pandehur, pasi që dikush ju ka paditur, ose jeni ngarkuar me një shkelje të trafikut ose vepër penale;
  - Jeni dëshmitar i ftuar për të dëshmuar;
  - Jeni ekspert në fushën tuaj dhe u është kërkuar të vini në gjykatë dhe t'i ndihmoni asaj për shkak të ekspertizës tuaj.



- **Cilat janë të drejtat tuaja para gjykatës?**
  - Keni të drejtë të përfaqësoheni nga një avokat. Nëse nuk mund të përballoni të paguani një avokat, gjykata do të caktojë një avokat për të ju përfaqësuar, por vetëm në rastet penale, pra nëse jeni të akuzuar për kryerjen e një vepre të rëndë penale.
  - Nëse merrni ndihmë sociale mund të përfaqësoheni nga një avokat në raste të tjera përveç rasteve të së drejtës penale.
  - Në rrethana të caktuara mund të përfaqësoheni nga një avokat pro-bono (që nënkupton pa pagesë), si për shembull nëpërmjet një organizate.
  - Keni të drejtë të përfaqësoni prova dhe të ftoni dëshmitarë që mbështesin deklaratat tuaja.

- **Çfarë është roli i prokurorit?**
  - Prokurori është praktikues i së drejtës i cili përfaqëson shtetin në një rast penal. Prokurori ka autoritetin dhe përgjegjësinë për ndjekjen penale të personave të akuzuar për çfarëdo vepër penale dhe akte të tjera të specifikuara me ligj.

- **Çfarë është roli i policit?**

Roli i policit është që:



  - të mbrojë jetën, pronën dhe të ofrojë siguri për të gjithë personat;
  - të mbrojë të drejtat njerëzore dhe liritë themelore të të gjithë qytetarëve;
  - të parandalojë rrezikun ndaj qytetarëve dhe të mbajë rendin dhe sigurinë publike;
  - të zbulojë dhe parandalojë veprat penale dhe kryerësit e tyre që të kryejnë vepra të tilla;
  - të hetojë veprat penale dhe kryerësit e tyre;
  - të mbikëqyrë dhe kontrollojë sigurinë e trafikut;
  - të menaxhojë dhe kontrollojë kufirin shtetëror;
  - të ofrojë ndihmë gjatë fatkeqësive natyrore dhe emergjencave të tjera.

- Në çdo stacion policor ka njësi të veçanta që përbëhen nga zyrtarë policorë të cilët janë të trajnuar posaçërisht që të mund të merren me situata të ndryshme, për shembull në lidhje me dhunën në familje, trafikimin me qenie njerëzore ose krime të tjera specifike të cilat ndikojnë në grupet më të cenueshme të



shoqërisë. Viktimat kanë të drejtë të flasë për një zyrtare policore femër, nëse dëshirojnë, dhe zyrtarët policë gjithashtu janë të trajnuar që të merren me të miturit dhe personat e tjerë të cenueshëm të cilët janë të dyshuar për kryerjen e ndonjë krimi.

- **Çka janë avokatët e viktimave?**[56]

Avokatët e viktimave janë profesionistë të trajnuar për të mbështetur viktimat e krimit dhe garantuar që të drejtat e viktimave të përfaqësohen gjatë procedurave penale. Avokatët u ofrojnë viktimave informata, mbështetje emocionale, dhe u ndihmojnë në gjetjen e burimeve dhe plotësimin e dokumenteve. Avokatët gjithashtu mund të përfaqësojnë viktimën para gjykatës dhe mund të kontaktojnë organizata, siç janë ato të drejtësisë penale ose agjencitë e shërbimeve sociale, për të marrë ndihmë ose informata për viktimat.

Avokatët punojnë me zyrën e prokurorit të shtetit në qytete të ndryshme. Avokatët e viktimave zakonisht kanë diplomë universitare për drejtësi dhe janë të përgatitur dhe të trajnuar mirë për të punuar me viktimat.[57]

Në kuadër të zyrave të avokatëve të viktimave ekziston një linjë telefonike e pandërprerë e pa pagesë ku njerëzit mund të telefonojnë për të marrë informata, mbështetje apo për të raportuar një krim. Avokatët janë të përkushtuar që gjatë komunikimit me viktimat të ruajnë nivelin më të lartë të mundshëm të konfidencialitetit.

- **Si punojnë avokatët me viktimat?**



Avokatët u ofrojnë viktimave informata mbi me opsionet e ndryshme në dispozicion të tyre dhe i përkrahin viktimat në marrjen e vendimeve të tyre. Avokatët nuk u tregojnë viktimat çfarë të bëjnë dhe janë të përkushtuar të ruajnë nivelin më të lartë të mundshëm të konfidencialitetit gjatë komunikimit me viktimat.

- **Nëse jeni viktimë**

Mund ta keni të vështirë të arrini deri te ndihma, por mund ta zbuloni se avokatët e viktimave mund të ju ofrojnë informata, mbështetje dhe qasje në shërbime të dobishme për të cilat mund të mos keni njohuri. Viktimat shpesh ndjehen të lehtësuar kur e dinë se agjencitë në komunitetin e tyre duan të sigurohen që ata janë të sigurtë dhe të marrin ndihmën që u duhet për të marrë veten nga ndikimi i krimit të kryer ndaj tyre.

[56] Ueb-faqja e Qendrës Kombëtare të Viktimave të Krimit (The National Centre for Victims of Crime), në dispozicion në http://www.victimsofcrime.org/help-for-crime-victims/get-help-bulletins-for-crime-victims/what-is-a-victim-advocate-, qasur më 12/05/2014

[57] Rregullore mbi Mandatin, Strukturën dhe Funksionimin e Zyrës për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimve, në dispozicion në http://www.psh-ks.net/repository/docs/Nr.1188.2013-Rregullore_mbi_Mandatin_,Strukturen_dhe_Funskionimin_e_ZMNV....pdf, qasur më 12/05.2014

- **Çfarë është roli i një avokati?**

Avokati jep ndihmë juridike në mënyrë profesionale, të ndërgjegjshme dhe dinjitoze, në përputhje me ligjin dhe kodin e mirësjelljes. Avokatët janë të detyruar nga privilegji avokat-klient, gjë që nënkupton se të gjitha informatat e ndara me ta duhet të mbahen konfidenciale dhe nuk mund të kërkohen nga ndonjë institucion tjetër për të zbuluar atë që u ka thënë klienti i tyre. Për të ushtruar profesionin, avokati duhet të jetë anëtar i Odës së Avokatëve.

- **Çfarë është aktgjykimi?**

Aktgjykimi është vendim i formës së prerë i gjykatës për zgjidhjen e kontestit dhe përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të palëve të përfshira në një rast. Gjykata gjithashtu mund të nxjerrë vendime të tjera gjatë procedurës.

Sistemi Gjyqësor i Kosovës


Gëzimi i të drejtave të njeriut varet në masë të madhe nga funksionimi i sistemit gjyqësor. Në këtë aspekt, gjykatat e rregullta përbëjnë një mekanizëm që siguron drejtësi. Pushteti gjyqësor në Republikën e Kosovë ushtrohet nga gjykatat. Sistemi gjyqësor është unik, i pavarur, i drejtë, i paanshëm dhe apolitik, dhe siguron qasje të barabartë për të gjithë. Gjykatat e rregullta kanë juridiksion në çështjet civile, penale dhe administrative, dhe Gjykata Kushtetuese merret me çështjet e kushtetutshmërisë.



- Sistemi i gjykatave të rregullta përbëhet nga Gjykata e Lartë, Gjykata e Apelit dhe Gjykatat Themelore (si dhe 20 degë, të cilat veprojnë në kuadër të gjykatave themelore në tërë Kosovën)[58]. Gjykatat duhet të trajtojnë të gjithë personat në mënyrë të barabartë, pa diskriminim në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, besimit fetar, mendimit politik ose tjetër, origjinës kombëtare a shoqërore, lidhjes me cilindo komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose çfarëdo statusi tjetër personal[59].

[58] Neni 4 i Ligjit nr. 03/L-199 mbi Gjykatat, (2010) dhe Ligji për plotësim-ndryshimin e Ligjit nr. 03-L-199 mbi Gjykatat, në dispozicion në http://gzk.rks-gov.net/SearchIn.aspx?Index=2&s=law%20on%20courts%20&so=1, qasur më 05/05/2014
[59] Neni 7 i Ligjit nr. 03/L-199 mbi Gjykatat, (2010) dhe Ligji për plotësim-ndryshimin e Ligjit nr. 03-L-199 mbi Gjykatat, në dispozicion në http://gzk.rks-gov.net/SearchIn.aspx?Index=2&s=law%20on%20courts%20&so=1, qasur më 05/05/2014

Sistemi i gjykatave në Kosovë





- Gjykata Kushtetuese është autoriteti përfundimtar për interpretimin e Kushtetutës dhe përputhshmërisë së ligjeve me Kushtetutën. Gjykata Kushtetuese e Kosovës është themeluar në janar të vitit 2009. Me autoritetin e saj për shqyrtimin e legjislacionit dhe kërkesave individuale të të drejtave të individit, Gjykata ushtron kontrollin e fundit mbi pushtetin legjislativ dhe ekzekutiv në Kosovë dhe është arbitri më i lartë për interpretimin e dispozitave kushtetuese për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut.

Mekanizmat e tjerë jo-gjyqësorë që u ofrojnë mbështetje viktimave të shkeljes së të drejtave të njeriut

- **Institucioni i Avokatit të Popullit në Kosovë (IAP)**
  IAP është institucion i pavarur i mandatuar për të adresuar shkeljet e pretenduara të të drejtave të njeriut nga institucionet publike në Kosovë. IAP zhvillon hetime në bazë të ankesave individuale ose me nismën e vet, pra pa dëshirën e viktimave (rastet *ex officio*), publikon raporte

dhe ngrit vetëdijen në lidhje me të drejtat e njeriut në Kosovë. IAP ofron shërbime pa pagesë dhe pranon ankesa nga çdo person në Kosovë. IAP mund të luajë rol kyç në ofrimin e mbështetjes viktimave të dhunës në familje përmes adresimit të mangësive në lidhje me zbatimin e ligjit për mbrojtjen nga dhuna në familje i cili ndikon në të drejtat e viktimave të dhunës në familje[60].

- **Zyrat e Qarkut për Ndihmë Juridike**
  Zyrat për Ndihmë Juridike u ofrojnë ndihmë juridike falas viktimave që kualifikohen për një mbështetje të tillë. Ato lehtësojnë qasjen e viktimave në drejtësi, për shembull, duke u ofruar viktimave informata dhe këshilla që kanë të bëjnë me të drejtat e tyre ligjore, duke përfaqësuar viktimat para gjykatave ose organeve administrative dhe duke ndihmuar me hartimin e dokumenteve ligjore dhe në procedurat ligjore.[61]

- **Agjencia për Barazi Gjinore (ABGj)**
  ABGj funksionon në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, si organ i veçantë që duhet të promovojnë, zhvillojë, japë këshilla dhe të monitorojë në zbatimin e ligjeve dhe politikave që lidhen me barazinë gjinore në Kosovë.[62]

- **Njësitë Komunale për të Drejtat e Njeriut (NjKDNj-të) dhe Zyrtarët Komunalë për Barazi Gjinore (ZKBGj-të)**
  NjKDNj-të janë mekanizma përgjegjës për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut në nivel komunal, në përputhje me ligjet, politikat dhe standardet ndërkombëtare. ZKBGj-të kanë për detyrë kryesore të udhëheqin programet komunale që kanë të bëjnë me barazinë gjinore, me qëllim që të sigurohet zbatimi i ligjeve relevante për barazi gjinore dhe standardet e tjera të lidhura me të drejtat e njeriut. Si NKDNj-të ashtu edhe ZKBGj-të mund të kontribuojnë në parandalimin e dhunës në familje nëpërmjet aktiviteteve të ngritjes se vetëdijes dhe rrjetëzimit me akterët kryesorë, me qëllim të mbrojtjes më të mirë të viktimave të dhunës në familje[63].

- **Organizatat joqeveritare (OJQ-të), grupet punuese komunale (GPK-të) dhe grupe task forcat**
  OJQ-të, GPK-të dhe task forcat luajnë rol të rëndësishëm në përkrahjen e viktimave të shkeljeve të të drejtave të njeriut. GPK-të dhe task forcat zakonisht përbëhen nga palët e interesit në nivelin komunal që përfaqësojnë si institucionet publike ashtu edhe shoqërinë civile. OJQ-të që janë të njohur me një rast të dhunës në familje mund të kërkojnë urdhër mbrojtjeje, urdhër për mbrojtje emergjente dhe urdhër për mbrojtje emergjente të përkohshme.

[60] OSBE – Misioni në Kosovë, Katalog për këshilla dhe ndihmë për viktimat e dhunës në familje, në dispozicion në http://www.osce.org/sq/kosovo/88709?download=true, qasur më 12/05/2014
[61] Poaty
[62] Poaty
[63] Poaty

7 PËRFUNDIME: TË DREJTAT NJERËZORE TË GRAVE

Duke qenë se **të drejtat e njeriut** janë një tërësi të drejtash/garancish të cilat kanë të drejtë t'i gëzojnë dhe u përkasin të gjitha qenieve njerëzore, historia tregon se, megjithatë, grave u është dashur të **luftojnë për njohjen** e të drejtave të tilla që duhet t'i gëzojnë, dhe për këtë arsye flasim për të drejtat njerëzore të grave. Kjo në vetvete mund të duket kontradiktë në terma, pasi që kjo i vë gratë në një pozicion disi më të dobët, të cilat kanë nevojë për "të drejta të veçanta". Megjithatë, historia, kultura dhe praktikat tradicionale kanë bërë që stereotipat e ngulitur të vazhdojë të jenë të pranishme në të gjitha shoqëritë, përfshirë në Kosovë, të cilat ndikojnë të ketë pengesa të cilat bëjnë që gratë të mos gëzojnë të drejtat e tyre njerëzore.

Disa nga të drejtat për të cilat grave historikisht u është dashur **të bëjnë fushatë të ashpër** në mbarë botën përfshijnë:

- Zotërimin e pronës;
- Kërkimin e divorcit dhe mundësinë për të paditur;
- Qasjen në planifikimin e familjes;
- Të qenit të mbrojtura nga përdhunimi, sulmet seksuale ose abuzimin nga dhuna në familje;
- Të kenë të drejtën të votojnë dhe të zgjedhen;
- Të qenit të arsimuara;
- Ushtrimin e profesioneve të njëjta si burrat; dhe
- Në kultura të ndryshme, është konsideruar e papërshtatshme që gratë të dalin vetëm apo të marrin vendime që u ndryshojnë jetën, si për shembull me kë të dalin, të kenë lidhje romantike ose me kë të martohen.

Në anën tjetër, përkundër faktit se janë bërë shumë përmirësime në legjislacionin dhe ndryshime në qëndrimet e tyre, gratë vazhdojnë të përballen me pengesa, përfshirë si në vijim:

- Për shkak të normave kulturore, disa gra nuk e trashëgojnë pasurinë të cilën kanë të drejtë ta trashëgojnë (ato ose nuk pyeten ose heqin dorë nga kjo e drejtë), detyrohen të jetojnë në lidhje të dhunshme dhe nuk mendojnë se është e pranueshme të kërkojnë divorc, ndërsa disa detyrohen të martohen shumë herët, përfshirë gjatë moshës së fëmijërisë;
- Femrat vazhdojnë të përballen me seksizëm dhe diskriminim në vendin e punës, në forma si të mos qenit të paguara njëjtë si burrat për të njëjtën punë, mohimi i ngritjes në detyrë ose largimi nga puna gjatë shtatzënisë me qëllimin e shmangies së pagesave të pushimit të lindjes;
- Nëse gratë ankohen për shkeljen e të drejtave të tyre, jo çdoherë u besohet ose merren seriozisht nga autoritetet përkatëse; për shembull nëse keqtrajtohen nga bashkëshorti ose përdhunohen nga ndonjë i panjohur;
- Disa shoqëri akoma nuk besojnë se gratë duhet të kenë të njëjtat të drejta si burrat dhe të drejtat e tyre kufizohen në mënyrë drastike, përfshirë, ndër të tjera, në forma si moslejimi për të dalë vetëm, mohimi i së drejtës së tyre për arsimim, detyrimi për t'u martuar ose pasur fëmijë, moslejimi që të punojnë dhe/ose drejtojnë automjete.

Në përgjithësi, Kosova mbetet një shoqëri kryesisht patriarkale, ku qëndrimet stereotipike janë të pranishme dhe kjo ndikon në mundësinë që femrat të jetësojnë të drejtat e tyre. Kjo është e pranishme në një numër sferash të shoqërisë kosovare, përfshirë në forma si në vijim:

- Përfshirja e ulët e grave në politikë dhe mungesa e besimit në mesin e popullatës se ato janë të afta të përfaqësojnë njerëzit;
- Femrat përballen me vështirësi në qasje në kredi bankare, nisjen e bizneseve dhe pasjen e posteve ekzekutive në kompanitë publike ose private;
- Mos-jetësimin nga femrat të së drejtës për të trashëguar pasuri, për shkak të qëndrimeve tradicionale/presionit shoqëror, gjë që rezulton që ato të heqin dorë nga e drejta e tyre për të trashëguar pasuri dhe/ose tokë;
- Prekja e femrave nga dhuna në familje (emocionale/psikologjike/fizike), të cilat nganjëherë ndjehen të bllokuara në lidhje të tilla, gjendje e cila përkeqësohet për shkak të gjendjes së varësisë nga bashkëshortët e tyre (të qenit ekonomikisht joaktive) dhe përgjigjes joadekuate nga shteti, i cili dështon të marrë seriozisht akuzat ose të merret në mënyrë të shpejtë me kryerësit;
- Femrat përballen me diskriminim në vendin e punës, përfshirë ngacmimet seksuale, si dhe të mos qenit të paguara në mënyrë të barabartë me meshkujt, pamundësia për t'u ngritur në detyrë dhe madje humbja e vendeve të punës për shkak të shtatzënisë;
- Femrat nga grupe të caktuara të komuniteteve ose fetare mund të përballen me **diskriminim të shumëfishtë**, gjë që nënkupton se diskriminohen për shkak të gjinisë, si dhe të përkatësisë etnike ose besimit fetar. Kjo është veçanërisht problematike pasi që kufizon seriozisht të drejtat njerëzore të grave, qoftë në punësim, trashëgimi, në poste publike apo kur përballen me dhunën në familje;
- Gratë gjithashtu mund të preken negativisht nga praktikat tradicionale si martesat me shkuesi apo martesat e hershme, të cilat ndikojnë në të drejtën e tyre për të pasur një jetë private dhe familjare; dhe
- Gratë mund të mos kërkojnë kompensim për shkelje të ndryshme të të drejtave të tyre, qoftë në vendin e punës ose në shtëpi, për një numër arsyesh (si mungesa e njohurive mbi procedurat/mungesa e besimit për t'u ankuar), gjë që nënkuptojnë se nuk sigurojnë drejtësi për shkeljet që ndodhin.

Në lidhje me të gjitha më sipër, është me rëndësi të theksohet se po vazhdon të ketë përparime në mbarë botën dhe Kosova nuk përbën përjashtim. Megjithatë, një nga sfidat më të mëdha mbeten qëndrimet e thella stereotipike dhe praktikat e dëmshme tradicionale që ekzistojnë, të cilat i pengojnë gratë të gëzojnë të drejtën e tyre në mënyrë të barabartë me burrat. Prandaj, një nga mënyrat më të mira për të përmirësuar këtë gjendje është që të vazhdon të ketë diskutime për të drejtat njerëzore të grave, qoftë në shkollë, në shtëpi ose në vendin e punës, për të siguruar që të drejtat e njeriut për të gjithë të jetësohen, e jo të mbesin vetëm angazhim apo ideal.

ANEKS I: AKTIVITETI 1: PYETËSORI I TEMPERATURËS SË TË DREJTAVE TË NJERIUT[64]

Ju lutemi lexoni me kujdes pyetjet e mëposhtme. Shfrytëzoni pak kohë për të shqyrtuar secilën deklaratë para se të zgjidhni një numër në shkallët e rangimit, i cili, sipas mendimit tuaj, më së miri e përshkruan shkollën dhe komunitetin tuaj. Juve u është dhënë *një kopje e Deklaratës Universale të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut (DUDNj)*. Në fund të secilës pyetje përmenden nenet përkatës të DUDNj-së, në kllapa. Pasi të keni mbaruar mblidhni pikët dhe shkruani rezultatin e përgjithshëm në fund – ai rezultat është ***Temperatura*** juaj ***e të Drejtave të Njeriut***.

Shkallët e rangimit:

1 = Jo ose Asnjëherë

2 = Rrallë

3 = Nganjëherë

4 = Shpesh

5 = Po ose Çdoherë

Shembull

Shkolla ose komuniteti ynë është një vend ku secili ndjehet i lumtur. (Nëse të gjithë në shkollën tuaj i shihni duke ecur me buzëqeshje të madhe në fytyrën e tyre gjatë tërë kohës, atëherë duhet të zgjidhni numrin 5 – "po ose çdoherë".)

1 2 3 4 5

[64] Ky ushtrim është marrë dhe përshtatur nga: Amnesty International, 'Becoming a Human Rights Friendly School: A guide for schools around the world' (shq. 'Ta bësh një shkollë miqësore ndaj të drejtave të njeriut: udhëzues për shkollat nëpër botë'), 2012, në dispozicion në http://amnesty.org/en/library/asset/POL32/001/2012/en/7b237c0f-6568-41dd-9fdd-d60817e88f77/pol320012012eng.pdf qasur më 25/03/2014.

1. Kosova është vend ku të rinjtë janë të mbrojtur dhe të sigurt (Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, nenet 3 dhe 5).

1 2 3 4 5

2. Askush në shkollën ose në komunitetin tim nuk diskriminohet për ndonjë arsye, për shembull për shkak të fesë së tyre, mënyrës se si vishen, fesë së tyre, asaj se kush janë miqtë e tyre, ngjyrës së lëkurës së tyre, kastës ose klasës së cilës i përkasin, apo asaj se çfarë bëjnë kur nuk janë në shkollë (DUDNj, nenet 1, 2 dhe 16).

1 2 3 4 5

3. Shkolla dhe komuniteti im ofrojnë qasje, burime dhe aktivitete të barabarta për të gjithë (DUDNj, nenet 2 dhe 7).

1 2 3 4 5

4. Secilit në shkollën dhe komunitetin tim i ofrohen informata dhe inkurajohet në mënyrë të barabartë për mundësitë akademike, ekstra-kurrikulare (jashtë mësimit) dhe ato për karrierë (DUDNj, neni 2).

1 2 3 4 5

5. Unë kam liri për të shprehur bindjet dhe idetë (kulturore, politike, fetare apo besimet e tjera) të mia pa frikë nga të qenit i diskriminuar, ngacmuar ose tallur (DUDNj, nenet 18 dhe 19).

1 2 3 4 5

6. Shkolla dhe komuniteti im mirëpresin nxënësit, familjet, mësuesit dhe stafin tjetër me prejardhje dhe kulturë të shumëllojshme, sidomos me prejardhje të ndryshme etnike (DUDNj, nenet 2, 6, 13, 14 dhe 15).

1 2 3 4 5

7. Shkolla dhe komuniteti im janë demokratike. Secili në shkollën time (nxënësit, mësimdhënësit, personeli ndihmës dhe prindërit) dhe në komunitetin tim lokal ka mundësi për të marrë pjesë në marrjen e vendimeve për gjërat që i prekin ata, siç janë rregullat dhe politikat e shkollës (DUDNj, nenet 20, 21 dhe 23).

1 2 3 4 5

8. Kur dikush sillet keq, ose kur ndodh një incident në shkollën time, secili i përfshirë në të trajtohet në mënyrë të drejtë dhe në të njëjtën mënyrë nga ana e mësimdhënësve dhe drejtuesve të shkollës gjatë punës në zbulimin e asaj se çfarë ka ndodhur dhe në të vendosurit se çfarë dënimi duhet dhënë (DUDNj, nenet 6, 7, 8, 9 dhe 10).

1 2 3 4 5

9. Kur dikush në shkollën time bën diçka që ndikon negativisht në të drejtat e një personi tjetër, atij/asaj i ndihmohet që të mësojë se si të ndryshojnë sjelljet (DUDNj, neni 26).

1 2 3 4 5

10. Kur ndodhin konflikte (mosmarrëveshje ose grindje) në shkollën time, ne përpiqemi t'i zgjidhim përmes mënyrave jo të dhunshme dhe bashkëpunuese (DUDNj, nenet 3, 5 dhe 28).

1 2 3 4 5

11 Kur dikush akuzohet se ka bërë diçka të gabuar në shkollën ose komunitetin tim, ata konsiderohen të pafajshëm derisa të dëshmohet se janë fajtorë (DUDNj, neni 11).

1 2 3 4 5

12. Askush në shkollën ose në komunitetin tim nuk trajtohet ose dënohet në një mënyrë që është degraduese apo mizore, ose që e bën atë të ndjehet më pak se njerëzor (DUDNj, nenet 4 dhe 5).

1 2 3 4 5

13. Nëse në shkollën time ka një ankesë për ngacmim ose diskriminim, ekzistojnë politika dhe procedura në fuqi për t'i trajtuar ato (DUDNj, nenet 3, 6 dhe 7).

1 2 3 4 5

14. Pjesëtarët e shkollës dhe të komunitetit tim mund të prodhojnë dhe të shpërndajnë buletine dhe publikime të tjera, pa frikë të censurimit ose ndëshkimit (DUDNj, nenet 19 dhe 27).

1 2 3 4 5

15. Të gjithë në shkollën time inkurajojnë njëri-tjetrin për të mësuar në lidhje me problemet globale që lidhen me drejtësinë, mjedisin, varfëria dhe paqen (DUDNj, Preambula dhe nenet 26 e 29).

1 2 3 4 5

16. Në shkollën time kemi mundësi të dëgjojmë, lexojmë dhe mësojmë në lidhje me jetën, qëndrimet dhe idetë e njerëzve të tjerë; mendime të ndryshme përfaqësohen në plan-programin, tekstet e bibliotekën tonë dhe në hapësirat tona publike (DUDNj, nenet 2, 19 dhe 27).

1 2 3 4 5

17. Njerëzit të cilët punojnë në shkollën time paguhen aq mirë sa që të gëzojnë një standard të mjaftueshëm jetese për veten dhe familjet e tyre dhe të marrin ditë standarde pushimi dhe të paguhen gjatë pushimeve (DUDNj, nenet 4, 22, 24 dhe 25).

1 2 3 4 5

18. Në shkollën dhe komunitetin tim respektohet hapësira dhe pasuria personale e çdo personi (DUDNj, nenet 12 dhe 17).

1 2 3 4 5

ANEKS II: ACTIVITY: QËLLOJANI KUSH E KA ZBULUAR KËTË: *A NDIKOJNË QËNDRIMET E NJËANSHME GJINORE NË GJYKIMIN TONË?*

Emrat e shpikëseve	***Produktet***
1.	Fshesa a xhamit të përparshëm të automjeteve
2.	Metoda e re për zhvillimin e filmave
3.	Ngjitësi
4.	Pelena 'barkë'
5.	Pambuku me ngjyrë
6.	Ngjyrë për shkrim (që mund të fshihet)
7.	Pajisja për mbajtjen e kafshëve
8.	Gjuha e Përbashkët për Orientim në Afarizëm – COBOL (gjuhë kompjuterike)
9.	Qesja e letrës
10.	Kevlar (material që përdoret për veshje antiplumb dhe qëllime të tjera)
11.	Komunikimi i spektrit të gjerë
12.	Përparësja për mbajtjen e foshnjave
13.	Brusha për krehjen e flokëve
14.	Preparati kundër njollave
15.	125 patenta për kontribut në industrinë e fibrave dhe të tekstilit
16.	Biskota me copa të vogla çokollate
17.	Printeri me sistemin 'Blyssimbol': që nga vitet 1960, personat me aftësi të kufizuara të theksuara mësojnë të komunikojnë duke përdorur një sistem simbolesh të quajtur Blissmybol.

BIBLIOGRAFIA

Konventa:

Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave, 18 dhjetor 1989

Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, e plotësuar-ndryshuar me Protokollet nr. 11 dhe 14, 4 nëntor 1950

Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, 16 dhjetor 1966

Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, 16 dhjetor 1966

Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, 10 dhjetor 1948

Deklarata:

Deklarata për Eliminimin e Dhunës ndaj Grave, 20 dhjetor 1993

Deklarata e Vjenës dhe Programi për Veprim, miratuar nga Konferenca Botërore për të Drejtat e Njeriut në Vjenë, 25 qershor 1993

Parimet Jogxhakartës, Zbatimi i së Drejtës Ndërkombëtare për të Drejtat të Njeriut në lidhje me Orientimin Seksual dhe Identitetin Gjinor

Rekomandime:

Rekomandimi 2010 (7) i Këshillit tw Evropës – Karta mbi Edukimin për Qytetari Demokratike dhe Edukimi për të Drejtat e Njeriut, 11 maj 2010

Legjislacion kombëtar:

Kushtetuta e Jugosllavisë, 1946

Kushtetuta e Republikës së Kosovës, 2008

Ligjit kundër Diskriminimit – 2004/3

Ligjit për Qasje në Dokumentet Publike - 03 / L-215

Kodi Penal i Kosovës - 04 / L-082

Ligji për Gjykatat - 03 / L-199

Ligji për Dhunën në Familje - 03 / L-182

Ligji për Familjen - 2004/32

Ligjit për Barazi Gjinore - 2004 / 2

Ligji për Arsimin e Lartë - 04 / L-037

Ligji për Trashëgiminë - 2004/26

Ligji i Punës - 03 / L-212

Ligji për Arsimin Parauniversitar - 04 / L-032

Ligji për Arsim dhe Aftësim Profesional - 04 / L -138

Raste:

Gëzim dhe Makfire Kastrati kundër Gjykatës Komunale në Prishtinë dhe Këshillit Gjyqësor të Kosovës, rasti nr. KI 41/12, në dispozicion në http://www.gjk-ks.org/repository/docs/gjkk_ki_41_12_shq.pdf

Dokumente nacionale:

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, 'Korniza e kurrikulës për arsimin parashkollor, fillor, të mesëm dhe të mesëm të lartë', 2010

Prokuroria e Shtetit, 'Rregullorja mbi mandatin, strukturën dhe funksionimin e Zyrës për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave', 24 tetor 2014

Udhëzues:

Amnesty International, 'Becoming a Human Rights Friendly School: A guide for schools around the world' (shq. 'Të bësh një shkollë miqësore për të drejtat e njeriut: udhëzues për shkollat në mbarë botën'), 2012

Amnesty International, 'Facilitation Manual – a guide to using participatory methodologies for human rights education' (shq. 'Doracak për të ndihmuar në organizim aktivitetesh – udhëzues për përdorimin e metodologjive pjesëmarrëse për edukimin për të drejtat e njeriut'), 2011

Këshilli i Evropës, 'Compass: Manual for human rights education with young people' (shq. 'Kompas: doracak për edukim për të drejtat e njeriut me të rinj'), Botimi i vitit 2012

Këshilli i Evropës, 'Gender Matters: A manual on addressing gender-based violence affecting young people' (shq. 'Gjinia ka rëndësi: manual për trajtimin e dhunës me bazë gjinore që ndikon tek të rinjtë'), 2007

Këshilli i Evropës, 'Manual for facilitators in non-formal education (shq. 'Doracak për lehtësues të edukimit joformal), 2009

Këshilli i Evropës, 'Teaching democracy – a collection of models for democratic citizenship and human rights education' (shq. 'Të dhënit mësim për demokracinë – koleksion i modeleve për qytetari demokratike dhe edukimin për të drejtat e njeriut), 2008

Këshilli i Evropës, 'Taking part in democracy – lesson plans for upper secondary level on democratic citizenship and human rights education' (shq. 'Të marrësh pjesë në demokraci – plane mësimore për nivelin e mesëm të lartë për qytetari demokratike dhe edukimin për të drejtat e njeriut'), 2010

Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë/Zyra për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut, 'Guidelines on human rights education for secondary school systems' (shq. 'Udhëzime për edukimin për të drejtat e njeriut për sistemet e shkollave të mesme'), 2012

Remer & Talbott, 'Educator's Guide – Vision 2020, Equality in Sight', Drexel University College of Medicine – Institute for Women's Health and Leadership, 2010

Raporte:

At all, 'Ngrite zërin kundër dhunës ndaj grave – 16 ditë aktivizëm 2013', Prishtinë, 2013. Në dispozicion në http://kreatoda.com/upload/E-Libri_Albanian.pdf.

Farnsveden U, Qosaj-Mustafa A, Farnsworth N, 'Profili gjinor i vendit – Kosovë', 2014

Qendra Kosovare për Studime Gjinore, 'E drejta e grave për të trashëguar prona në Kosovë', 2011, në dispozicion në http://www.womensnetwork.org/documents/20130530153942831.pdf

Qendra Kosovare për Studime Gjinore, 'Si votojnë gratë në Kosovë', 2005, në dispozicion në http://kgscenter.net/images/stories/howdowomenvoteinkosovo.pdf

Qendra Kosovare për Studime Gjinore (QKSGj), 'Prania e dhunës në marrëdhëniet e adoleshentëve', 2012, në dispozicion në http://www.unfpakos.org/wp-content/uploads/2012/12/Prevalence-of-violence-alb-finale-DRINI.pdf

Qendra për Arsim e Kosovës, 'Hulumtim mbi konceptet e qytetarisë në mesin e nxënësve të shkollave në Kosovë', prill 2014

Avokuesit e Minnesotas për të Drejtat e Njeriut, Causes and Effects of Gender-Based Violence (shq. Shkaqet dhe efektet e dhunës me bazë gjinore), janar 1996, në dispozicion në http://www.stopvaw.org/uploads/causes_effects_5-19-2003.pdf

NORMA, 'Hulumtimi dhe monitorimi i zbatimit të Ligjit për Barazi Gjinore, 2010, në dispozicion në http://www.norma-ks.org/repository/docs/norma_alb_(10)_(1).pdf

OSBE – Misioni në Kosovë, 'Katalog për këshilla dhe ndihmë për viktimat e dhunës në familje', në dispozicion në http://www.osce.org/sq/kosovo/88709?download=true

Organizata Botërore e Shëndetësisë, Violence against Women Pack (shq. Paketa rreth dhunës ndaj grave), 1997

Artikuj të tjerë:

Barlovic B, Matejcic B, 'The role of women from World War II to Post-War Yugoslavia. From anti-fascist fighters to unknown heronies' (shq. 'Roli i grave nga Lufta e Dytë Botërore deri në Jugosllavinë e pasluftës. Nga luftëtare antifashiste në heroina të panjohura'), në dispozicion në http://www.geschichtswerkstatt-europa.org/media/projekte/The%20role%20of%20women.pdf

Bourke J, 'Women on the Home Front in World War One' (shq. 'Gratë në frontin e vendlindjes gjatë Luftës së Parë Botërore'), në dispozicion në http://www.bbc.co.uk/history/british/britain_wwone/women_employment_01.shtml

Qendra Evropiane për Çështje të Minoriteteve në Kosovë, Buletin informativ: Rasti i Diana Kastratit: dhuna në familje dhe drejtësia kosovare, dhjetor 2013, Në dispozicion në https://ecmikosova.org/the-diana-kastrati-case-violence-against-women-and-kosovar-justice/

Pen International, 1960: Musine Kokalari, në dispozicion në http://www.pen-international.org/campaign/past-campaigns/because-writers-speak-their-mind/because-writers-speak-their-minds-50-years-50-cases/1960-musine-kokalari/

The Guardian, 'A timeline of the women's right to vote – interactive' ('Kronologji e së drejtës së grave për të votuar – interaktive'), 6 korrik 2011, në dispozicion në http://www.theguardian.com/global-development/interactive/2011/jul/06/un-women-vote-timeline-interactive

Fjalime:

Sekretari i Përgjithshëm Thorbjorn Jagland, fjalim me rastin e lansimit të Komisionit të ri të Këshillit të Evropës për Barazi Gjinore, 6 qershor 2012

Ueb-faqe:

BBC History; http://www.bbc.co.uk/history/historic_figures/norton_caroline.shtml

Care International; http://www.careinternational.org.uk/what-we-do/war-conflict-and-peacebuilding/conflict-related-sexual-violence/news-kosovo-men-learn-news-ways-to-be-a-man

Klubi 'Bëhu burrë', Care International; http://www.yeu-international.org/en/publications/newsmail/small-stories-that-can-change-the-world/be-a-man-club-stop-violence-against-girls-and-women

Ueb-faqja e Qendrës Kombëtare të Viktimave të Krimit (origj. National Centre for Victims of Crime), në dispozicion në http://www.victimsofcrime.org/help-for-crime-victims/get-help-bulletins-for-crime-victims/what-is-a-victim-advocate-

Çmimi Nobel: http://www.nobelprize.org/nobel_prizes/facts/ dhe http://www.nobelprize.org/nobel_prizes/lists/women.html

Fondi i Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Popullsi: http://www.unfpa.org/rights/principles.htm

ECMI Kosova

Rr. Nëna Terezë Nr. 41, Apt. 29
10000 Prishtinë, Kosova
Tel. +381 (0) 38 224 473

Rr. Cika Jovina Nr. 3, 1st Fl
38220 Mitrovicë, Kosova
Tel. +381 (0) 64 00 55 488

Email: info@ecmikosova.org
Web: ecmikosova.org

